

VERA DHE IMANI JOT



Imani është në rrezik, imani që buron thellë në zemër, gojën e shprehësit e hijeshon dhe sinqeritetin e tërë kësaj me gjymtyrë dhe veprime e vërteton është bërë objektiv sulmi nga shumë anë. Stina e verës që është një nga mirësitë e panumërta të Allahut po shfrytëzohet në mënyra nga më të ndryshmet dhe të çuditshmet për ta luftuar, cinguar, shkërmoqur madje edhe për ta zhdukur imanin tek Allahu. Njerëz që flasin gjuhën tonë dhe që kanë pirë të njëjtin ujë si ne, gjejnë aso hilesh dhe dredhish për t'i larguar njerëzit nga rruga e xhenetit, saqë edhe shejtani me siguri ua ka zili, sesi ka mundur t'u shkojë mendja ashtu. Gjërat e neveritshme ia bëjnë të dashura, gjërat e ulëta emancipim, të keqen të mirë, Sunetin ekstremizëm dhe mosbesimin përparim e evropianizim!

Në stinën e verës lakuriqësia e pashembullt që po shtohet çdo ditë e më shumë është sfida më e përqendruar, e ndihmuar nga qarqe të llojllojshme për të prishur atë që gjendet e shëndoshë vetëm te muslimanët, **familjen**. Fatkeqësisht ndikimi i thirrjeve të tyre ka pasur një ndikim marramendës te shumë njerëz, madje edhe te shumë sish që i ruajnë vlerat me këmbëngulje. Nëse dikujt i duket se po hiperbolizohet konstatimi, se lakuriqësia e femrave rrezikon imanin e njerëzve, unë e përkujtoj atë me fjalët e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*: *“Pas meje, nuk kam lënë fitne më të dëmshme për burrat, sesa gratë”*.

Nëse meshkujt bien në këtë sprovë, atëherë do të mbesin të pafuqishëm për të qenë thirrës drejt mirësisë nëpër familjet e tyre përballë të këqijave që ndodhin, d.m.th. devijimi i tij mund të shkaktojë anomali edhe te familja e tij dhe te gjithë ata që e rrethojnë. Ne duhet të jemi syçelët për rrezikun që na kanoset, dhe më pas të mos lejojmë të bëhemi viktima të “ushtrive” kaq të dobëta. I përshkruaj të dobëta megjithëse përgatitjet dhe fondet e tyre janë shumë të mëdha, sepse kam parasysh përkrahjen dhe udhëzimet e të Plotfuqishmit, i Cili na krijoi dhe e përsosi krijimin tonë. Ai na zbriti Librin, na dërgoi të dërguar për të shpjeguar se e gjithë ajo që është në Libër mund të jetësohet dhe praktikohet. Na mësoi që mbrojtja e shikimit është më e pastër për ne, se *“kush braktis diçka për hir të Allahut, Ai ia zëvendëson me diçka më të mirë”*, se *“nëse ju e ndihmoni fenë e Allahut, Ai do t'ju ndihmojë juve”*. Madje Pejgamberi lavdërimi dhe paqja qoftë mbi të, na ka mësuar se kur flemë me gratë tona fitojmë shpërblim, në atë rast besimtarët e pyetën: O i Dërguar, si ka mundësi që ne të kënaqim epshin dhe për këtë të fitojmë shpërblim? *“Po sikur ta kryente në haram, a nuk do të dënohej për këtë?! – iu përgjigj Pejgamberi sal-lallahu alejhi ue selem*.

Këto mësimet duket se kanë filluar të lulëzojnë në shoqërinë shqiptare, prandaj ditëve të fundit ka një përqendrim aq të shprehur kundër Islamit në përgjithësi dhe kundër shamisë në veçanti. Por kur imani prek në brendi sigurisht do të japë fryte nga jashtë dhe këtë askush s'e ndalon dot. O Allah, na bëj të kënaqemi me hallall për të mos pasur nevojë për haram dhe na bëj të kënaqemi me Ty për të mos u treguar nevojtarë para të tjerëve.

Në emër të redaksisë: Omer BERISHA

AKTUALE

3-5 | RËNIA E SKËNDERBEUT DHE NGRITJA
E "NËNË TEREZËS"

6-8 | KAMPIONATI BOTËROR, SPORT DHE GJËRA TË TJERA

9-11 | BLIC LAJME

SFIDA

12-15 | KËNAQËSITË SHPIRTËRORE TË XHENETIT (1/2)

AKIDE

16-21 | XHELOZIA PËR FENË E ALLAHUT (2/2)

DRITARE

22-24 | SHAMIA – SIMBOL, DETYRIM DHE TEST

25-28 | VERA MES PROVËS DHE SPROVËS

FIKH

29-32 | ÇFARË BËNI KUR SHKONI NË DET...?

EKONOMI

32-35 | MURABAHA

FAMILJA

36-38 | BETEJA E VËRTETË E GRUAS

39-42 | FLIRTI DHE TRADHTIA BASHKËSHORTORE (4/4)

42-44 | T'I MËSOJMË FËMIJËT E VEGJËL PËR VLERËN E
PRIVATËSISË

TEFSIR

45-48 | EUFORIA PËR PUNË MËKATI

HADITH

49-52 | DO TË ARRIJË ATY KU FUTET DRITA DHE TERRI

THESARE

53-55 | ABDESI DHE ENERGJIA E NJERIUT

AVANCIMI PERSONAL

56-58 | MESHKJUT DHE FEMRAT

FETVA DHE KONSULTIME

58-60 | VËNIA E BASTIT PËR GARA?

REDAKSIA

Kryeredaktor: Omer BERISHA

zv. kryeredaktorë: Agron TERZIQI dhe Justinian TOPULLI

Anëtarë të redaksisë:

Ismail BARDHOSHI, Bledar HAXHIU, Lulzim SUSURI, Talha KURTISHI, Genc PLUMBI,
Ali SHABANI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Llokman HOXHA, Rashit ZYLFIU dhe Hajrush MANI

Bashkëpunëtorë: Ahmed KALAJA, Ekrem AVDIU dhe Enis RAMA

Redaktor gjuhësor: Roald HYSA

Redaktor teknik: Halil BERISHA

Ballina: Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio)

Shpërndarje dhe marketing: Sedat RAMADANI

Boton: Albislam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000

email: albislam@gmail.com

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOËL

Xhirologaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A. D. – Skopje

Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit
PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.albislam.com



RËNIA E SKËNDERBEUT DHE NGRITJA E “NËNË TEREZËS”

(Skënderbeu tashmë ka rënë nga kali dhe po i mëshohet fuqishëm mitit të “nënë Terezës”. Shoqëria shqiptare po tregon se vuan për modelet e duhura për t’i ndjekur. Koha e shpatës ka mbaruar, ndërsa modeli kozmopolitan i “nënë Terezës”, nuk i përshtatet realitetit nacionalist që duan të përvijojnë shtetarët shqiptarë, kudo ku janë.)

Përpara pak kohësh të gjithë mediat e shkruara dhe elektronike shqiptare u përfshinë në një debat të fuqishëm mbi librin studimor

“Skënderbeu” të studiuesit të shquar zviceran **Oliver Jens Shmit**. Nuk mbeti njeri pa e rrahur gjoksin dhe me fjalë mburravece të mbarsura me tone të

forta nacionaliste u munduan të përbaltin një vepër studimore, të cilën 95% e tyre as që e kishte lexuar. Gara e të shprehurit me tone të nxehta i tejkaloi kufijtë e normales dhe ata që bërtisnin më tepër ishin pikërisht ata që nuk e kishin lexuar fare. Miti i nacionalizmit nuk mund të shprehej më mirë, se sa nga kjo kategori njerëzish, të cilët deri dje ngritën mitologjinë nacional-komuniste dhe vazhdojnë t'i fryjnë teorisë së nacionalizmit në kushtet e reja të krijuara. Ndërkaq një fushatë e re nacionaliste moderne është ngritur tashmë mbi kryqet false të të ashtuquajturës nënë Tereza, e cila nuk e ka mohuar qenien e saj si shqiptare, por edhe nuk ka qenë aq krenare për këtë identitet. Gjithsesi fama botërore e fituar si një shenjtore e gjallë dhe fituese e çmimit Nobel nuk është se i ka sjellë ndonjë përmirësim imazhit të Shqipërisë dhe Shqiptarëve deri tashti. Ndërsa kjo nuk i ka ndaluar qeveritë shqiptare të pas-demokracisë të përpiqen maksimalisht për ta shfrytëzuar figurën e saj. Të shtyra dhe të nxitura nga qarqe katolike vendase figura e kësaj gruaje gati-gati na është kthyer në ikonë kombëtare dhe shenjtore e një kombi, që në shumicën e tij dërrmuese është musliman, për të mos thënë se edhe shumë tradita të krishtera janë të ndikuara nga shumica muslimane. Por kjo nuk i ka ndaluar aspak klanet katolike brenda shtetit shqiptar dhe në Kosovë të vazhdojnë me diskriminimin e historisë dhe emri “nënë Tereza” gjendet në shumë vende

“Të shtyra dhe të nxitura nga qarqe katolike vendase figura e kësaj gruaje gati-gati na është kthyer në ikonë kombëtare dhe shenjtore e një kombi, që në shumicën e tij dërrmuese është musliman...”

publike, si spitali qendror i Tiranës, sheshi qendror tek universiteti po i Tiranës, aeroporti kryesor i vendit në Rinas mban emrin dhe një shtatore të saj e vendin gati sa nuk e kapi një epidemi patriotizmi, që kush mund të emëronte më tepër vende e të ngjashme me emrin e saj. Madje edhe në kartën e identitetit u propozua që të vendosej fytyra e nënë Terezës, por u desh një ndërhyrje e fortë e Forumit Musliman, që kjo të mos realizohej dhe sot kartat e identitetit të shqiptarëve të kenë një paraqitje tjetër.

Me tonelata letër u shpenzuan për Skënderbeun që nga Rilindësit, në kohën e Mbretërisë, nën regjimin komunist dhe u desh një studiuës i huaj, që nuk iu përshtat kritereve të mitologjizimit nacionalist të ringjallte “dashurinë” e nacionalistëve shqiptarë ndaj kësaj figure. Por reagimi ishte i shkurtër dhe Skënderbeu ra nga kali për t’ia lënë përsëri vendin një tjetër figure të krishtere, një tjetër “atleti të

Krishterimit”. Kësaj radhë një femre me përmasa kozmopolitane. E njohur si bamirësja e Kalkutës, por që nuk ka lënë vend të botës pa shkuar, në mos fizikisht nëpërmjet medieve të ndryshme, duke u ngritur në një figurë kulti idhujtarie ndërkombëtare. Gjithsesi shumë njerëz do të sillnin argumente nga më të ndryshme të bazuara në fakte, se misioni i saj nuk ka qenë thelbësisht bamirësia, por krishterizimi i popullsisë indiane, apo ndihmesa në krishterizimin e popullsisë të tjera, ku kjo grua ka qenë e pranishme nëpërmjet qendrave të saj misionare. Rëndom është akuzuar për këtë dhe jo vetëm për këtë, por edhe për anashkalime e devijime të misionit të saj bamirës, duke sjellë në vende të ndryshme edhe dëme materiale. Ne jse kjo nuk është në qendër të vëmendjes së këtij shkrimi. Bamirësja ndërkombëtare nuk e ka pasur si synim të saj identitetin shqiptar, i cili nuk do t'i sillte asnjë përfitim nga donatorët ndërkombëtarë. Identiteti i saj si bamirëse e krishterë dhe ligjërimi i saj në emër të Jezusit ka qenë në qendër të vëmendjes së punës së saj të përditshme, si dhe përhapja e këtij mesazhi në përmasa globale. Ndërkaq përmasat globale nuk i përshtaten përmasave të nacionalizmit shqiptar të ndryrë në 28,000 km², apo qoftë edhe sikur t'i shtojmë atij edhe mijëra kilometra të tjera të trojeve shqiptare në Ballkan. Atëherë me të drejtë na lind pyetja, pse qarqet katolike shqiptare të pranishme në segmente të ndryshme të Shtetit Shqiptar, si dhe tashmë në

“Identiteti i saj si bamirëse e krishterë dhe ligjërimi i saj në emër të Jezusit ka qenë në qendër të vëmendjes së punës së saj të përditshme...”

Kosovë po i fryjnë me shumë zell kësaj figure kontroverse dhe të diskutueshme, edhe për nga pikëpamja nacionaliste?

Përkujtimi i 100-vjetorit të “nënë Terezës” në TKOB në Tiranë, si të ishte një ceremoni e organizuar nga kleri katolik ishte një shfaqje e hapët e kësaj tendence mitologjizuese, mistifikuese e njëkohësisht krishterizuese. Në shtypin e përditshëm madje pati edhe reagime ndaj kësaj maskarade të drejtuar nga drejtori i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Ardian Marashi. Ata që po e rrahin gjoksin sot më tepër për kontributet e dhëna ndaj këtij vendi janë të krishterët katolikë me priftërinjtë e tyre, ku në krye të radhës kanë vënë të ashtuquajturën “nënë Tereza”.

Ky vend ka mbetur tashmë pre’ e figurave të diskutueshme dhe pa autoritetin e duhur për të qenë modeli i duhur për shoqërinë shqiptare, që akoma nuk e ka përmbyllur fazën tranzitore, si dhe për shqiptarët e Kosovës, që sapo e kanë nisur këtë fazë. ■

KAMPIONATI BOTËROR, SPORT DHE GJËRA TË TJERA

Më ka rastisur që t'i pyes disa të rritur, të cilët janë të ndikuar nga futblli, rreth disa njohurive historike, të cilat janë aq të thjeshta, saqë ato i di edhe një fëmijë, mirëpo ata nuk kishin njohuri për të dhënë një përgjigje

AHMED ASAF

Para pak ditëve në Afrikën Jugore ka filluar kampionati botëror i futbollit. Njëherësh ky kampionat konsiderohet si gara më e rëndësishme e organizuar nga federata botërore e futbollit "FIFA". Kjo garë organizohet në krye të çdo katër viteve dhe ka filluar për herë të parë në vitin 1930 duke përjashtuar dy kampionate; atë të vitit 1942 dhe 1946 për shkak të Luftës së Dytë Botërore. Shpenzimet për organizimin e një gare kapin shifrën e një miliard e gjysmë dollarë, duke iu referuar prononcimeve zyrtare të vetë FIFA-s.

Sipas asaj që flitet, rezulton se shpenzimet për këtë garë për vitin 2014, e cila do të mbahet në Brazil do ta tejkalojë dyfishin e shifrës aktuale. Kjo shumë tejkalon buxhetin e shumë shteteve të varfra, dhe sikur kjo të shpenzohet sipas mënyrës së duhur do të eliminohej një pjesë e varfërisë, do të largohej një pjesë e urisë, do të zhdukeshin përfundimisht sëmundjet dhe epidemi të ndryshme nga shumë vende, apo do të ruhej ambienti nga cenime të ndryshme të qëllimshme apo të paqëllimshme. Ndoshta me këtë shumë

parash do të arrihej paqja dhe siguria në shumë vende, që nuk i gëzojnë ato. Kjo garë në një farë mënyre realizon një farë urë-lidhje mes shteteve, urë kjo që do të ishte e mirë sikur të mos e cenonte identitetin dhe elementet bazë të kulturës dhe civilizimit tonë, dhe sikur t'i ruanim përbërësit e këtij civilizimi me besim të plotë në to dhe me krenari.

Mirëpo për fat të keq ajo që e vërejmë tek fëmijët dhe të rinjtë tanë është, se ata kanë njohuri shumë më tepër për kampionatin botëror të futbollit, lojtarët, simbolet dhe festimet e tyre, se sa kanë njohuri për gjigantët e fesë sonë, qofshin ata të hershëm apo edhe bashkëkohorë.

Më ka rastisur që t'i pyes disa të rritur, të cilët janë të ndikuar nga futblli, rreth disa njohurive historike, të cilat janë aq të thjeshta, saqë ato i di edhe një fëmijë, mirëpo ata nuk kishin njohuri për të dhënë një përgjigje. Kam frikë se futblli do të fikë tek këta muslimanë dritën e dashurisë dhe urrejtjes për hir të Allahut, do t'i asimilojë dallimet mes feve dhe do t'ua ndryshojë renditjen e gjërave sipas rëndësisë së tyre, duke ua paraqitur kështu si gjënë më të rëndësishme fushat e futbollit dhe jo fushat e përparimit dhe të prosperitetit.

Sa e kotë dhe e pavlerë është ajo kohë, e cila kalohet pranë ekraneve, duke shikuar ato gara që padrejtësisht quhen kampionate. Orë të tëra humben duke i përcjellë ato drejtpërdrejtë, po aq orë humben duke i shikuar të përsëritura dhe kësaj i shtojmë këtu edhe kohën e parashikimeve para ndeshjes, vlerësimet mes dy pjesëve dhe analizat pas përfundimit të ndeshjes. Nuk është e shkurtër koha kur analizohen paraqitjet e lojtarëve, trajnerëve e gjyqtarëve, si dhe veprimet e tifozëve. Ndoshta do të vijë koha kur do të komentohen edhe takimet dhe bisedat jashtë fushës së lojës. Sikur kjo

kohë të shfrytëzohej në gjëra të dobishme do të ishte shumë më mirë për fenë dhe jetën tonë.

Karshi kampionatit të meshkujve mbahet edhe kampionati për femra. Një kampionat i tillë për herë të parë u mbajt në vitin 1991 në Kinë, kryeqyteti i së cilës organizoi kongresin e femrës në vitin 1995. Kampionati i gjashtë i femrave do të mbahet në Gjermani në vitin 2011.

Dihet fare mirë se disa vende islame kanë ekipe futbollit të femrave! Gjithashtu nuk mohohet se përkrahësit e futbollit për femra në vendet islame dhe në Arabinë Saudite, do të kërkojnë edhe ekipe lokale



për femra, dhe nëse nuk mund t'i arrinin pretendimet e tyre, atëherë do t'i porosisin pasuesit e tyre, që i kanë në mjetet e informimit, që të përgatisin terrenin për një skenar të tillë. Kështu ta angazhojnë shoqërinë me një gjë të tillë dhe të bëjnë presion në klasën politike, se ndoshta pas një farë kohe do të gjejnë terren më të përshtatshëm dhe përkrahje nga përgjegjësit fetarë e shoqërorë në arritjen e këtij synimi. Tek njerëz të tillë nuk ka rëndësi provokimi i atdheut nga bota, për shkak të ekipit të femrave, e kush mund të thotë se nesër kjo gjë nuk do të ishte ndër elementet bazë për çdo veprim të mëtejshëm.

Vlen të theksohet se "Asambleja Botërore e Rinisë Islame" dhe revista "Al-Xhumua" në gjuhën angleze, vepruan drejtë kur u morën vesh, që të marrin pjesë në kampionatin botëror, në mënyrë që njerëzit t'i njoftojnë për Islamin, se ndoshta Allahu do t'i udhëzojë disa prej tyre në Islam e disa të tjerë do ta ndryshojnë bindjen e tyre për Islamin. Sikur pasanikët muslimanë të merrnin pjesë në një projekt të tillë; ofhtë edhe me vënien e reklamave brenda stadiumeve, apo përmes kanaleve televizive, të cilat i transmetojnë drejtpërdrejtë ndeshjet e kampionatit, dhe që në vitin 2006 arritën në më tepër se 200, kjo do të kishte qenë diçka e mirë. Ky numër i madh i kanaleve televizive tregon shikueshmërinë e lartë që ka kampionati botëror. Numri i atyre që e përcollën finalen e kampionatit botëror të vitit 2006 arriti në një miliardë e gjysmë, ndërsa statistikat tregojnë se numri i tyre që i përcollën të gjitha ndeshjet gjatë atij kampionati kaloi shifrën e dyzet miliardëve. Ku janë pasanikët karshi kësaj dobie të madhe?

Mirëpo përkundër imazhit të mirë të disa organizatave tona humanitare dhe

“Përkundër imazhit të mirë të disa organizatave tona humanitare dhe informative, imazhin e tyre e prishi në masë të madhe Al-Kaida, e cila i kërcënoi pjesëmarrësit në kampionat...”

informative, imazhin e tyre e prishi në masë të madhe Al-Kaida, e cila i kërcënoi pjesëmarrësit në kampionat. Allahu na e lehtësoftë udhëzimin neve dhe atyre.

Në këtë kampionat botëror Organizatat nga shoqëria civile kanë një shans tejet të mirë, të pastër dhe të drejtë, meqë e tërë bota po vlon për shkak të sulmit më çnjerëzor të çifutëve ndaj Flotës së Lirisë, ku vranë, plagosën dhe keqtrajtuuan njerëz të pafajshëm, të cilët gjendeshin në këtë flotë. Këto organizata duhet që ta përdorin menjëherë këtë rast për demaskimin e mburrjes së çifutëve, mospranimin e pushtimit dhe të bllokadës së tyre. Madje ata duhet të përpiqen edhe me organizimin e flotave të tjera në të cilat do të merrte pjesë së paku nga një person prej secilit shtet. ■

Përktheu: Rasim HAXHA

BRITANIKËT EDHE PESË VITE NË AFGANISTAN

Dejvid Riçards, kreu i Armatës Britanike pyetjes, se kur do të tërhiqen trupat amerikane nga Afganistani tha: “Varet me kë flet për këtë gjë. Kjo nuk është vija zyrtare që vjen nga Shtëpia e Bardhë apo Pentagoni”, “Unë mendoj se ne mund të jemi të angazhuar në Afganistan nga tre deri në pesë vitet e ardhshme, dhe ky është mendim i Ministrisë së Mbrojtjes.

” Edhe pse numri i forcave ushtarake që dominohen nga ato të SHBA-ve janë përmbi 150.000, kryengritja talebane vazhdon të jetë në formën më të mirë, që nga rrëzimi i tyre nga pushteti në vitin 2001. Sipas strategjisë së Obamës, trupat e SHBA-ve do të fillojnë tërheqjen graduale në Korrik të vitit 2011, duke ua dhënë udhëheqjen forcave qeveritare afgane. Ende nuk është i ditur numri i atyre që do të tërhiqen apo si do të ndodhë kjo. Trupat britanike kanë qenë të angazhuara kohëve të fundit në luftimet më të ashpra në krahinën e Helmandit. Numri i ushtarëve të vrarë britanikë tani ka arritur në 300, gjë që ka ndikuar shumë në rënien e mbështetjes për luftë nga ana e publikut britanik. Kryeministri i ri britanik e ka larguar opsionin e dërgimit të trupave shtesë në misionin në Afganistan, duke thënë se trupat britanike nuk duhet të

qëndrojnë atje “as edhe një ditë më tepër” sa ç’është nevoja.

EDHE SPANJA NDALOI “PERÇEN”

Senati spanjoll ka miratuar papritur një mocion që ndalon përdorimin e perçes në hapësirat publike. Ky propozim ka arritur të marrë shumicën e votave pas aprovimit edhe nga Partia Popullore e nacionalistëve katalanas dhe navarrëve. Pak kohë pasi shumë komuna në vendin iberik ndaluan përdorimin e perçes, tashmë vjen edhe një vendim zyrtar, që pritet të ngjallë reagimin e besimtarëve muslimanë. Nisma të ngjashme janë ndërmarrë edhe në Francë e shumë vende të tjera evropiane.

KLINTON MBËSHTET HOMOSEKSUALIN KLODI

Nëpër botë janë shtuar ndalesat për mbulesën, sulmet dhe vrasjet ndaj muslimanëve të pafajshëm, ndërsa në anën tjetër një nga personat më me influencë në botë, sekretarja amerikane e shtetit Hillary Clinton, i del në mbrojtje homoseksualit nga Shqipëria, Klodian Çelës. Gjatë fjalimit në Departamentin Amerikan të Shtetit, sekretarja amerikane

ka përmendur Shqipërinë ndër vendet ku është evidentuar diskriminimi ndaj homoseksualizmit. Klinton siguroi mbështetjen ndaj Klodit duke theksuar edhe angazhimet e Ambasadorit Withers për këtë çështje. Gjatë fjalimit të saj mbi të drejtat e personave me orientim seksual të parregullt zonja Clinton tha: “Një djalë i ri i quajtur Klodian Çela deklaroi në një emision shumë popullor në Shqipëri prirjet e tij seksuale.” Pas deklarimit të hapur në televizion të homoseksualitetit të tij, Klodian Çela u përball me protesta e kërcënime të njëpasnjëshme. Ndërkaq familja e tij u largua nga qyteti i Lezhës, duke u shprehur se jetesa ishte bërë e pamundur mes presioneve dhe kërcënimeve të njerëzve.

SKANDALET PËR KORRUPSION I AFROHEN EDHE VATIKANIT

Njëri prej kardinalëve më të shquar në Itali dhe një ish-ministër janë vënë nën hetime, në lidhje me një skandal për korrupsion që ka goditur qeverinë dhe tani po i afrohet edhe Vatikanit. Kardinali Sepe Crescenzo dhe ish-ministri i transportit Pietro Lunardi po hetohen për korrupsion, thonë burime gjyqësore, ku të përmendurit kanë bërë favorizime në dhënien e kontratave për punë publike, si

dhe në organizime të mëdha përfshirë aty organizime në restaurimin e kishave me çmime më të larta. Është një rrjet i tërë korrupsioni në mes kompanive ndërtuese, arkitektëve dhe punëtorëve të shërbimeve civile, që ka përfshirë dhjetëra miliona euro kontrata. Gjithashtu në këtë rrjet bëjnë pjesë edhe i arrestuari Angelo Balduci, ish-kryetar i departamentit për inspektimin e punimeve të qeverisë, si dhe këshilltari për ndërtime në departamentin ku bën pjesë kardinali Sepe. Një muaj pas arrestimit të tij Balduci ishte zënë me një skandal të ri në mes tij dhe Vatikanit, ku incizimet e bëra e përfshijnë atë dhe pjesëtarë nga Vatikani në një rrjet prostitucioni të meshkujve.

AMERIKANËT NUK DËSHIROJNË XHAMI PRANË “GROUND ZERO”

Një propozim për ndërtimin e një qendre islame pranë “Ground Zero”, vendit ku dikur ngriheshin dy kullat binjake të “World Trade Center” në qytetin amerikan të Nju Jorkut, është përballur me kundërshtimin e ashpër të disa amerikanëve. Grupi “Cordoba Initiative”, i cili thotë se synon të përmirësojë marrëdhëniet muslimano-perëndimore, planifikon të ndërtojë një

qendër komunitare pranë atij vendi për të ndihmuar në përhapjen e mesazhit të tolerancës. Autoritetet lokale përfshirë këtu edhe kryebashkiakun e Nju Jorkut, Majkëll Blumberg, si dhe banorë të lagjes, e kanë mirëpritur këtë qendër, por një grup i vogël i udhëhequr nga lëvizja “Ndal Islamizimit të Amerikës!” thotë se qendra nuk ka pse të ndodhet pranë “Ground Zero”.

SHKOLLAT BRITANIKE NDALUAN FUNDE TË SHKURTRA DHE XHAKETA

Shkollat britanike ndaluan zyrtarisht, që nxënëset 15 vjeçare të mbajnë funde të shkurtra. Gjimnazi britanik „Shën Ajdens” publikoi kodin e ri shkollor të veshjes për vitin e ardhshëm shkollor, i cili i ndalon vajzat të moshës 15 vjeç, që të mbajnë funde të shkurtra, transmeton BGNES. Sipas rregullave të reja, vajzat në klasën e 11-të do të mund të mbajnë fustane të errëta në të cilat gjatësia më e shkurtër do të jetë 2 centimetra nën gjunj. Në një shkollë tjetër, e cila gjendet në Gloucestershir, drejtori ua ka ndaluar nxënësve të mbajnë xhaketa gangosh, funde të shkurtra, pantallona të gjera dhe bluza me jaka. Ndryshimet në „Shën

Ajdens” janë bërë për shkak të drojes, se nxënëset që tashmë shëtisin nëpër korridore me funde të shkurtra nxisin shikimet e djemve.

VËLLAI I JACKSON: ISLAMI KA MUNDUR TA SHPËTOJË MICHAEL-IN

Konvertimi në fenë islame ka mundur ta ruajë në jetë Michael Jackson, ka thënë Jermaine Jackson duke kujtuar vëllain e tij në një-vjetorin e vdekjes. Jermaine ka thënë për radion BBC World Service, se ai ishte munduar shpesh ta bindë Michael-in të konvertohet në Islam dhe të largohet nga Amerika. “Kam menduar se nëse Michael e përqafton Islamin ai ende do të ishte këtu sot dhe e them këtë për shumë arsye”. Vëllai i Michael-it po ashtu ka thënë se mbreti i popit nuk e kishte kundërshtuar idenë për t’u bërë musliman. “I gjithë grupi i tij i sigurimit u bënë muslimanë pasi ai kishte besim në Islamin, pasi ata njerëz që do të sakrifikonin jetën e tyre dhe po ashtu që do të përpiqeshin të ishin qeniet më të mira njerëzore, që mund të ishin, jo për Michael Jackson, por për Allahun. Prandaj të kesh gjithë ata njerëz rrotull, e dini se do të jeni të mbrojtur pasi kjo është një mbrojtje e Zotit”, ka shtuar Jermaine.

Përgatiti: Hajrush MANI

KËNAQËSITË SHPIRTËRORE TË XHENETIT (1/2)

Vëlla, erdhi koha të vendosësh: A do ta vazhdosh udhën në të cilën eci Ademi, në të cilën ftonte Nuhi, për të cilën u hodh në zjarr Ibrahim, dhe u shtri për t'u therur Ismaili. Për këtë udhë Jusufi u shit për pak dërhëmë, u nda me sharrë në dy pjesë Zekirjai dhe u vra Jahja

ABDURRAHMAN MUHAMED IMRAN

Angazhimi me vullnet të paepur në kërkim të shpërblimeve të xhenetit është realiteti i besimtarëve përgjatë shekujve. Ata me vigjilencë dhe zgjuarsësi i pengonin dhe i luftonin orvajtjet e djallit, që zemrat e tyre t'i lidhin me këtë botë kalimtare, t'i japin përparësi të përkohshme para shpërblimit të pafund në kopshtet e xhenetit, të cilët janë përgatitur dhe zbukurohen për banorët e tyre. I Dërguari i Allahut, i zgjedhuri i njerëzimit, *sal-lAllahu alejhi ue selem*, natën e kalonte në këmbë, duke falur namaz me përunjësi, këmbët e tij ënjtëshin... duke na dhënë kështu shembullin e



“Dynjaja është krijuar për ta kaluar dhe jo për ta pronësuar. Ajo është një udhë, e cila assesi nuk i ngjan vendbanimit të përhershëm..”

falënderuesit që shpreson **xhenetin**. Ebu Bekri, *radijallahu anhu*, gjatë leximit të Kuranit nuk mundte t'i ndalonte lotët, nga frika që të mos e humbi **xhenetin**. Në faqet e Omerit, *radijallahu anhu*, njeriut prej të cilit frikësohej edhe djalli i mallkuar ishin formuar dy rudha, që ishin shkaktuar nga lotët e besimtarit, që ishte i gatshëm të sakrifikojë çdo gjë për ta fituar **xhenetin**.

Osmani, *radijallahu anhu*, dhe hatmet e panumërta të Kuranit, një pamje reale e njeriut, i cili jetonte me fjalët e Allahut, duke i kërkuar me ngulm mirësitë e **xhenetit**. Aliu, *radijallahu anhu*, me mjekrën e tij të lagur nga lotët, në namazin e tij i kujtonte vetvetes shpresën e të gjithë besimtarëve, të mos mashtrohet me këtë dynja dhe me iluzionet e saj. Qëllimi i tij ishte **xheneti**.

Edhe gjenerata e ardhshme në këtë varg të gjeneratave të bekuara dhe të përzgjedhura e vazhdoi rrugën e jetës së vërtetë. E vërteta absolute, e cila ngjyrosi jetën e tyre ishte: Jam rob i Allahut, që e adhuron atë, e shpresoj **xhenetin** dhe frikësohem nga **xhehenemi**:

Hasan Basriu thoshte: Po mundohem të jetoj në këtë botë, duke u përballur çdo ditë me brengën: a do të jem prej fitimtarëve në ahiret.

Kur bija e Rebiut (ibën Huthajmit) e pyeti të atin e saj për shkakun e pagjumësisë së tij natën, ai iu përgjigj: Babai yt frikësohet, që të mos e përfshijë dënimi i papritur.

Jezid Rekashi dhe Mensur ibën Mutemiri agjëruan dyzet vjet dhe megjithatë thoshin: U vonuam, të mirët qëmoti na e kanë kaluar.

I nderuar, dynjaja është krijuar për ta kaluar dhe jo për ta pronësuar. Ajo është një udhë, e cila assesi nuk i ngjan vendbanimit të përhershëm. Mundohu që ta mposhtësh epshin, i cili anon nga dynjaja, shtoje sasinë e veprave të mira, ngaqë ndarja është e afërt. Mos u mundo të harrosh, sepse regjistrat e veprave janë realitet. Sa prej njerëzve, që dje ishin sot nuk janë. Pse je aq i sigurt, se vdekja do të vijë në momentin kur ti do të presësh atë????!!!... Shfrytëzoje kohën që të ka mbetur, vendose një herë e përgjithmonë, se çfarë kërkon, kalimtarin që do të zhduket apo të përhershmen, që Mëshiruesi e ka përgatitur për robërit e tij. Analizo pa nxitim çfarë të ofron kjo dynja dhe cilat janë mirësitë dhe kënaqësitë e **xhenetit**. Dëshirat e lidhura me këtë dynja janë zhgënjim në ahiret, nënshtrimi ndaj pasioneve dhe epshit do të rezultojë me dënim në ahiret. A nuk morët mësim nga sëmundja, e cila vjen pas shëndetit, nga dobësia, e cila vjen pas fuqisë, nga pleqëria, e cila vjen pas gjallërisë së rinisë...

Vëlla, erdhi koha të vendosësh: A do ta vazhdosh udhën në të cilën eci Ademi, në të cilën ftonte Nuhi, për të cilën u hodh në zjarr Ibrahim, dhe u shtri për t'u therur Ismaili. Për këtë udhë Jusufi u shit

“...Njeriut i pëlqen dhe ndjen kënaqësi, kur të tjerët shprehin dashuri dhe respekt ndaj tij. E kundërta ndodh kur ndaj tij shprehin urrejtja, përbuzja dhe mosrespektimi...”

për pak dërrhemë, u nda me sharrë në dy pjesë Zekirjai dhe u vra Jahja. Në këtë rrugë të **xhenetit** Ejubi durimtar u sprovua me sëmundje, humbjen e fëmijëve dhe të pasurisë... udhën drejt **xhenetit** ua treguan popujve të tyre Davudi, Sulejmani, Isai, Musai, Haruni dhe të gjithë pejgamberët, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta. Allahu, *subhanehu uve teala*, i dërgoi pejgamberët me shpallje, që pranojnë dhe drejtojnë natyrën e pastër njerëzore (fitren). Prej natyrës njerëzore është edhe dashuria ndaj kënaqësive. Ibën Tejmije kënaqësitë nga të cilat anon lloji njerëzor i ndan në tre kategori: kënaqësitë shqisore (ushqimi, pijet, marrëdhëniet intime...), kënaqësitë ideore (lavdërimi, nënshtrimi, glorifikimi) dhe kënaqësitë logjike, që i përkasin mendjes, siç është kënaqësia e njohjes së të vërtetës, njohjes së Allahut etj.

Një lloj i veçantë i kënaqësive që i do njeriu janë kënaqësitë ideore. Njeriut i pëlqen dhe ndjen kënaqësi, kur të tjerët shprehin dashuri dhe respekt ndaj tij. E kundërta ndodh kur ndaj tij shprehin urrejtja, përbuzja dhe mosrespektimi. Me këtë kategori kënaqësish do të shpërblehen edhe banorët e **xhenetit** dhe

me të kundërtën e tyre do të dënohen banorët e zjarrit, Allahu na ruajtë prej tij.

Vëlla i dashur dhe motër e nderuar, uluni në një vend të qetë, mos lejoni që t'ua tërheqë diçka vëmendjen dhe mundohuni ta paramendoni këtë situatë: jeni në shtëpinë tuaj të dashur, të rrethuar me njerëzit që i doni, prindërit, fëmijët, bashkëshortin/bashkëshorten, vëllezërit, motrat dhe ata në vazhdimësi ndaj jush shprehin fjalë dashurie, respekti, lutën për juve etj. Fjalët e ngrohta me të cilat e shprehin mirënjohjen e tyre ndaj juve nuk kanë të ndalur... Një situatë e këtillë me siguri do të shkaktonte një ndjenjë të fuqishme kënaqësie tek ju. Me këtë respekt dhe dashuri të shprehur ndaj njeriut, Allahu do t'i shpërblejë të gjithë besimtarët, që ia janë nënshtruar Krijuesit të tyre dhe që kanë ecur në rrugën në të cilën Ai ua ka caktuar.

Allahu, melekët, të Dërguarit e Allahut, besimtarët dhe të gjithë krijesat e duan besimtarin dhe për këtë më shumë do të lexoni në rreshtat në vijim. Do të fillojmë me një hadith të Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, të cilin na e përcjell Ebu Hurejre, *radijallahu anhu*: *“Kur Allahu e do robin e tij e thërret Xhibrilin dhe i thotë: Me të vërtetë unë e dua filanin (me emër) prandaj duaje edhe ti, dhe atë njeri e do Xhibrili. Pastaj Xhibrili u bën thirrje banorëve të qiellit duke thënë: Me të vërtetë Allahu e do filanin (me emër), prandaj dojeni edhe ju dhe pastaj ai (njeriu) bëhet i pranuar në tokë.”* (Buhariu dhe Muslimi)

Në një transmetim tjetër qëndron: *“Kur Allahu e do robin e tij, e thërret Xhibrilin dhe i thotë unë e dua këtë njeri, prandaj duaje atë. Pastaj dashuria e tij zbret tek banorët e tokës”*. Për këtë flet ajeti: *“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe*

bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t'u dhurojë dashuri.” (Merjem, 96). *Kur Allahu e urren ndonjë rob, e thërret Xhibrilin dhe i thotë unë e urrej këtë njeri, prandaj urreje atë. Pastaj urrejtja ndaj tij zbret në tokë.”* (Tirmidhiu, hadithi është i saktë). Lexoje edhe ajetin: *“Nuk i vajtoi ata, as qielli, as Toka, as nuk iu dha afat atyre.”* (Duhan, 29)

Mosvajtimi i qiejve dhe i tokës për banorët e zjarrit është shprehje e nënçmimit të tyre, zhvlerësimit ndaj tyre, për shkak të largimit prej Allahut. Gjurmët që lanë pas tyre janë vepra mospërfilljeje dhe rebelimi ndaj Allahut, janë vepra që i urren Krijuesi dhe me këtë e merituan mospërfilljen dhe urrejtjen. Një realitet krejtësisht ndryshe është për besimtarin. Muxhahidi thotë: *“Qielli dhe toka qajnë dyzet ditë për vdekjen e besimtarit, prandaj qaj edhe ti.”* Ebu Jahja tha: më habiti fjala e tij, ndërsa ai më tha: Pse habitesh. Si të mos qajë toka, të cilën e mbushi me ruku dhe sexhde. Si të mos qajë qielli në të cilin jehonin tekbiret dhe tesbihet e tij! Ibën Abasi, *radijallahu anhu*, ka thënë: Për besimtarin qan vendi ku është falur në tokë dhe vendi në qiell ku është ngritur vepra e tij. Biseda jonë e ka vazhdimin e saj... ■

**Përktheu dhe përshtati:
Talha Kurtishi**

XHELOZIA PËR FENË E ALLAHUT (2/2)

Ne dëshirojmë që xhelozinë për fe ta shfrytëzojmë dhe ta shpenzojmë pozitivisht e jo negativisht. Ta shpenzojmë duke ndërtuar e jo duke shkatërruar, që është një triumf real i fesë e jo të jenë veprime të pamatura dhe të nxituara, që sjellin dëm e jo dobi.

PROF. DR. NASIR EL OMER

Nuk ka dyshim se xhelozia për fenë, më së shumti shfaqet atëherë kur marrin hov të këqijat, dobësohet jetësimi i fesë dhe neglizhohen mësimet e fesë. Në aso rrethanash, zemra e besimtarit është në gjendje të tretet, ashtu siç tretet kripa në ujë. Nuk do mend se gjendja e tanishme nuk është sikur para njëzet viteve, tridhjetë viteve apo më shumë. Po ashtu nuk do mend se dukuritë negative janë shtuar dhe janë përhapur, ndërkohë që ne jemi të urdhëruar që ta ndryshojmë të keqen. Po ashtu është e dijshme se ne duam dhe angazhohemi për ta ndryshuar të keqen dhe shpresojmë të mos jemi më pak xhelozë për fenë e Allahut sesa disa njerëz impulsivë, mirëpo ne i ftojmë të gjithë që të jemi të një fjale, i ftojmë ata që t'i konsolidojmë hapat tonë sipas parimeve

të Sheriatit, i cili njeriun e mbron nga devijimi, e jo të jenë radhët tona të ndikuara nga egot dhe entuziazmi ynë. Ne dëshirojmë që xhelozinë për fe ta shfrytëzojmë dhe ta shpenzojmë pozitivisht e jo negativisht. Ta shpenzojmë duke ndërtuar e jo duke shkatërruar, që është një triumf real i fesë e jo të jenë veprime të pamatura dhe të nxituara, që sjellin dëm e jo dobi.

Për të qenë fisnike xhelozia për fenë, patjetër duhet të rregullohet sipas normave të Sheriatit të pastër. Duke mos i kufizuar, por duke marrë si shembull, prej normave do të veçojmë:

1. **Sinqeriteti.** Kjo nënkupton që xhelozia për fenë të jetë në të mirën e fesë e jo për të realizuar disa dëshira personale apo mendime individuale. Ekziston një masë ndarëse delikate në mes të faktit kur njeriu xhelozon dhe nevrkoset në rast të shkeljes së vijave të kuqe të fesë, për faktin se po



tejkalohen kufijtë e ndalesave të Allahut dhe faktit kur nevrikosja ndodh si rezultat i mospërfilljes së njerëzve të urdhrave të tij dhe pushtetit që ushtron mbi ta. Në këtë rast hidhërimi do të ishte për çështje personale e jo për Allahun e Lartësuar, Allahu na ruajttë!

2. **Egoja t'i nënshtrohet Sheriatit** e jo anasjelltas. Shembulli më eklatant për këtë është ndodhia ditën e marrëveshjes së Hudejbijes, kur i Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, nënshkroi marrëveshjen me politeistët dhe e pranoi

kushtin e tyre, që ata të mos hynë në Qabe atë kohë. Për shokët e të Dërguarit, kjo ishte një çështje e padurueshme, saqë Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, u bë konfuz kur i Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, e pranoi atë kusht të marrëveshjes. Omeri tregon për vete dhe thotë se i shkova të Dërguarit, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, dhe i thashë: A nuk je ti, i Dërguari i Allahut? Më tha - *PO!* A nuk jemi ne në hak, kurse armiku ynë në të kotën? - e pyeta. *PO*, - më tha. -E pse ne atëherë përcaktojmë më të keqen për fenë

tonë? – vazhdova. Ai më tha: “Unë jam i Dërguari i Allahut dhe nuk e kundërshtoj Atë duke qenë Ai që më ndihmon.” I thashë: Po, a nuk na thoshe ti, se ne do të vijmë dhe do të bëjmë tavaf rreth Qabes? - Po, mirëpo a të kam thënë se ne do të vijmë këtë vit? – më tha ai. -Jo – i thashë. -Ti do të vish dhe do të bësh tavaf rreth saj – më tha.

Pastaj thotë Omeri shkova te Ebu Bekri dhe i thashë: O Ebu Bekër, a nuk është ky me të vërtetë i Dërguari i Allahut? - Po – më tha. -A nuk jemi ne në hak, kurse armiku ynë në të kotën? – e pyeta. -Po – më tha. -E pse ne atëherë përcaktojmë më të keqen për fenë tonë? – vazhdova. Ai më tha: O burrë, ai është i Dërguari i Allahut dhe nuk e kundërshton Atë duke qenë Ai që e ndihmon dhe kapu pas yzengjisë së tij, - dhe më tha: Për Allahun ai e ka me vend.” I thashë: Po, a nuk na thoshte se ne do të vijmë dhe do të bëjmë tavaf rreth Qabes? - Tha -PO. A të ka thënë ai, se do të vish këtë vit në Qabe? - Jo – i thashë. - Do të vish dhe do të bësh tavaf rreth saj – më tha. Zuhriu thotë: ka thënë Omeri, se për këtë gjest timin kam vepruar disa gjëra¹ ka si qëllim disa ibadete shtesë për ta shpëgjuar këtë dilemë të tij rreth vendimit të Resulullahut.

Ne nuk dyshojmë se Omerin e kishte shtyrë të veprojë kësajsoj xhelozia e sinqertë e tij për fenë.

3. **Dija që sprova është rregull hyjnor** i vazhdueshëm, se Allahu i sprovon robërit e Tij për ta dalluar të sinqertin nga gënjeshtari. Allahu thotë: **“Elif, Lâm, Mîm. Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?! Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që Allahu të dallojë ata, që thonë të vërtetën dhe ata që gënjejnë.”** (Ankebut, 1 – 3)

¹ Buhariu dhe Muslimi.

² El-Fevaid, 1/208.

“...Masa popullore nuk ishte në gjendje ta dinte realitetin e Ibën Selulit, përpos anës së jashtme, se ai ishte bashkë me të Dërguarin, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, dhe ata nuk e dinin dyfytërsinë e tij në besim...”

Ibnul Kajimi – Allahu e mëshiroftë – ka thënë: Një njeri e pyeti imam Shafiuin, se cila është më e mirë për njeriun, t’i jepen mundësitë apo të sprovohet? Imam Shafiu u përgjigj: Nuk i hapen mundësitë njeriut pa u sprovuar. Allahu e sprovoi Nuhun, Ibrahimin, Musanë, Isain dhe Muhamedin, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi ta të gjithë, dhe kur ata duruan, Allahu ia hapi mundësitë e veprimit. Askush mos të mendojë se do ta zhdukë ndonjëherë dhimbjen tërësisht. Prandaj ky është një rregull i madh, të cilin duhet ta dijë çdo i mençur.²

4. Njohja e rregullit të Allahut **për mbrojtje njëri nga tjetri**. Allahu i Plotfuqishëm është i fortë për t’i ndaluar armiqtë e Tij nga veprimi i të keqes edhe më të vogël. Është i Fuqishëm që të triumfojë ndaj tyre dhe t’i shkatërrojë e t’i dënojë ata, por Ai, i lartësuar qoftë, ka caktuar që t’i sprovojë besimtarët me luftën ndaj armiqve të Tij. Allahu thotë: **“Sikur të donte Allahu,**

do t'i shkatërronte ata, por Ai dëshiron t'ju sprovovë juve me njëri-tjetrin." (Muhamed, 4).

Allahu po ashtu thotë: *"Sikur Allahu të mos i ndihmonte njerëzit e mirë kundër të këqijve, bota do të ishte shkatërruar."* (Bekare, 151).

Në ajetin tjetër Allahu thotë: *"Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t'u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut. Vërtet, Allahu e ndihmon këdo që e ndihmon Atë. Allahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm."* (Haxh, 40).

5. Dija se **ndryshimi i gjërave** është e lidhur ngushtë me **mundësinë**. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Kush sheh nga ju ndonjë të keqe, le ta ndryshojë atë me dorën e tij, nëse nuk mundet, atëherë me gjuhën e tij, e nëse prapë nuk mundet, atëherë me zemrën e tij, dhe kjo është shkalla më e ulët e imanit."*³ Kjo çështje është esenciale në operacionin e ndryshimit.

6. **Mosndërrhyrja** në kompetenca të huaja. Çdo njeri duhet t'i dijë patjetër të drejtat dhe detyrimet e tij, dhe t'i dijë kufijtë e refuzimit të së keqes, të cilët ia ka caktuar Allahu. Ka prej gjërave të këqija, që një individ mund t'i ndryshojë me dorën e tij, respektivisht me forcë, por ka disa të tjera, që nuk duhet t'i ndryshojë edhe nëse ka fuqi për to, por ato i takojnë udhëheqjes së shtetit, kështu individit i mbetet që ta kundërshtojë atë të keqe me gojë, nëse mundet, ose vetëm me zemër, por kjo e fundit siç u përmend më sipër është shkalla më e dobët e besimit.

7. Marrja parasysht e **interesave dhe e**

“Dëshpërimi dhe preokupimi i besimtarit me gjërat e këqija që sheh është gjë normale, me të cilën është krijuar çdo njeri normal, mirëpo besimtari nuk duhet që t'i tejkalojë kufijtë e tij...”

dëmeve të përgjithshme. Duke ndryshuar një të keqe, nuk duhet të sjellësh një të keqe më të madhe. Medoemos duhet të angazhohesh për ta shtuar të mirën dhe për ta pakësuar të keqen. Argument për këtë nga Suneti neve kemi ngjarjen, kur të Dërguarit, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, i kishte arritur një fjalë e keqe, të cilën e kishte thënë kryemynafiku, Abdullah Ibën Ubej Ibën Seluli dhe Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, u ngrit dhe tha: “O i Dërguari i Allahut, më lejo t'ia heq kokën këtij mynafiku!” Ndërkaq i Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, tha: *“Leje atë, se do të thonë njerëzit që Muhamedi po vret shokët e vet.”*⁴ Masa popullore nuk ishte në gjendje ta dinte realitetin e Ibën Selulit, përpos anës së jashtme, se ai ishte bashkë me të Dërguarin, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, dhe ata nuk e dinin dyfytërsinë e tij në besim (të cilën ia kishte zbuluar Allahu i Madhërishtëm). Prandaj nëse do ta vriste atë i Dërguari, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, vrasja e tij do të shndërrohej në provokim për shumë njerëz dhe pengesë për Islamin, pasi ata do të mendonin që

³Muslimi 1/69

⁴Buhariu, 4/181 dhe Muslimi, 4/1998

Muhamedi, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, po vret shokët e vet.

8. Njohja e **detyrës dhe e detyrimit**, që ka të bëjë me njeriun. Shumë të rinjve në kohë krizash dhe problemesh iu sillen nëpër kokë pyetje të shumta, se: çfarë duhet të bëjmë?, cila është detyra e jonë? etj. Përgjigja është e lehtë. Detyra e besimtarëve është detyra që kanë pasur të gjithë profetët. Allahu ka thënë: **“Për të dërguarit s’ka tjetër detyrë, veçse ta komunikojnë shpalljen qartë.”** (Nahël, 35). Allahu po ashtu duke iu drejtuar Muhamedit, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, thotë: **“dhe nuk je ngarkuar t’i detyrosh ata me forcë!”** (Gashije, 22). Po ashtu Allahu i ka thënë: **“Vërtet, ti (Muhamed) nuk mund të udhëzosh kë të duash.”** (Kasas, 56) Ndërsa nëse dikush ka kapacitet të punojë, apo është në vendin ku ka mundësi të kontribuojë më shumë për fenë e tij, le të veprojë me aq sa mundet!

9. Ndjekja e **vijës mesatare** në emocionet që kanë të bëjnë me çështjen e xhelozisë për fenë. Dëshpërimi dhe preokupimi i besimtarit me gjërat e këqija që sheh është gjë normale, me të cilën është krijuar çdo njeri normal, mirëpo besimtari nuk duhet që t’i tejkalojë kufijtë e tij. Allahu thotë: **“A mos vallë do të vrasësh veten nga pikëllimi, nëse ata nuk besojnë në këtë Fjalë (Kuran)?”** (Kehf, 6).

Ibën Kethiri – Allahu e mëshiroftë – ka thënë se fjala **“do të vrasësh...”**, ka si qëllim ta shkatërrosh veten me dëshpërimin për ta, pra, rezulton të thuhet: mos e shkatërro veten me pikëllim për ta, por transmetojua atyre mesazhin e Allahut. Kush udhëzohet, e ka për vete, e kush humb, humb kundër vetes, prandaj Ti mos e shqetëso veten deri në shkatërrim për humbjen e tyre!⁵

10. **Zbrazja e xhelozisë** në mënyrë

“...Ata që ishin të qetë, të matur, të ekuilibruar sipas Sheriatit të Allahut, nuk u goditën nga pesimizmi, por vazhduan të jenë optimistë, siç ishin edhe më parë...”

pozitive, jo anasjelltas. Sa njerëz i njohim që para njëzet viteve njiheshin me xhelozitë të ashpër për fenë e Allahut dhe me urrejtje ndaj gjërave të këqija, kurse disa prej tyre sot anojnë nga shpërthimet dhe shkatërrimet, por veprimi i tyre ka rezultuar me hidhësi. Kanë ndezur kundër vetes, familjeve të tyre dhe vendeve të tyre fatkeqësi e mjerime dhe veprimet e tyre nuk kanë sjellë asnjë rezultat. Pra, duhet ta orientojmë xhelozinë për fe kah ndërtimi, konstruktimi dhe lufta pozitive kundër çdo armiku, ashtu siç e meriton e jo kah shkatërrimi dhe destruktimi i vendeve të muslimanëve.

11. **Optimizmi** dhe mos-humbja e shpresës. Kur Musai, paqja e Allahut qoftë mbi të, i solli popullit të tij të vërtetën nga Zoti i tyre, dhe torturat e faraonit kundër tyre ishin të njëpasnjëshme, ata i thanë atij: **“Ne kemi vuajtur para se të vish ti dhe ende po vuajmë”**. Nuk pati se çfarë të bëjë Musai tjetër, pos t’ju marrë sihariq, siç është në vazhdim të ajetit: **“Musai tha: “Ndoshta Zoti juaj do ta zhdukë armikun tuaj dhe do t’ju bëjë sundimtarë në Tokë, për t’ju parë se si do të vepron!”** (Araf, 129) Ishte ky një sihariq, që e çoi në vend urdhrin e Allahut, ku thotë: **“Ne i shpallëm Musait dhe vëllait të tij: “Ndërtoni shtëpi për popullin tuaj në**

⁵ Tefsiri i Ibën Kethirit, 5/137.

Egjipt, shndërrojini ato në faltore dhe falni namazin! Dhe sillu lajmin e mirë besimtarëve!” (Junus, 87).

Kurse humbja e shpresës nga mëshira e Allahut është prej mëkateve të mëdha, siç iu tha Jakubi, paqja e Allahut qoftë mbi të, djemve të tij: **“Shpresën në mëshirën e Allahut nuk e humb askush, përveç jobsimtarëve”**. (Jusuf, 87).

Pesimizmi sjell rreziqe, siç shohim dhe dëgjojmë sot për disa njerëz neglizhues dhe të shkujdesshëm, të cilët më parë ishin njerëz entuziastë dhe impulsivë. Ata kur nuk panë efekte nga entuziazmi dhe nxitimi i tyre, u zbrapsën nga rruga – Allahu na ruajttë. Ndërsa ata që ishin të qetë, të matur, të ekuilibruar sipas Sheriatit të Allahut, nuk u goditën nga pesimizmi, por vazhduan të jenë optimistë, siç ishin edhe më parë. Ende iu vërehen shenjat e stabilitetit të tyre dhe të qetësisë shpirtërore, si dhe të atyre që janë rreth tyre, të cilët janë ndikuar nga thirrja e tyre, Elhamdulillah!

12. **Durimi** dhe mos-nxitimi. Ky është një kriter madhështor, të cilin e kanë harruar shumë njerëz. Durimi është njëri nga frytet e bindjes së thellë dhe besimit. Allahu i Madhërishëm në tri ajete ka thënë: **“Duro** (o Muhamed), **se me siguri premtimi i Allahut është i vërtetë!”** (Rrum, 60), (Gafir, 55) dhe (Gafir, 77). Pra lidhja e durimit me bindjen e thellë e materializojnë premtimin e Allahut të Plotfuqishëm, ndërsa i Madhërishmi ka premtuar, se do t'i ndihmojë robërit e Tij besimtarë dhe do t'ua mundësojë udhëheqjen në tokë, kur Ai thotë: **“Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu siç i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t'ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë**

asgjë (në adhurim). **Sa për ata që pas kësaj mohojnë** (besimin), **pikërisht ata janë të mbrapshtët.”** (Nur, 55).

Durimi nuk është një veprim negativ, siç mendojnë shumë njerëz, por ai është një veprim pozitiv, sepse nuk ndahet aspak nga të vepruarit e veprave të tjera të mira. Ky është durimi i lavdëruar, përndryshe do të ishte poshtërim dhe gjunjëzim.

13. Të larguarit nga **qortimi i tepërt** i vetvetes. Disa vëllezër e teprojnë në këtë drejtim dhe nuk janë të butë me vetveten e as me vëllezërit e tyre, por ngrejnë qortime e akuza për neglizhencë mbi të gjithë, duke supozuar se ata nuk po i kryejnë detyrat e tyre siç duhet. Kurse e kemi detyrim, që të gjejmë arsytetime dhe të jemi të drejtë me veten dhe vëllezërit tanë, të vlerësojmë angazhimin dhe fuqinë e shpenzuar, të ikim nga angazhimi i të tjerëve me atë që nuk mund ta bëjnë, apo t'ua ngarkojmë rezultatet që nuk i takojnë. E gjithë kjo është më afër që të unifikohet fjala, të konsolidohen radhët e muslimanëve, si dhe të mos ndizen zemrat e të humbasë këshillimi i ndërsjellë. Pa dyshim që përçarja dhe armiqësia i dobësojnë radhët e muslimanëve dhe i forcojnë energjitë e mynafikëve dhe laikëve.

Këto pra, janë disa kritere, të cilat mendojmë, se po të ruhen këto dhe të tjera, xhelozia për fenë e Allahut do të mbetet e lavdëruar, ashtu siç duhet të jetë, dhe bartësin e saj e çon drejt kënaqësisë së Allahut të Madhërishëm, dhe e ruan rrugën e thirrjes në fenë e Allahut prej shumë problemeve dhe pengesave. Allahu e di më së miri! ■

Nga arabishtja: Muhamed DËRMAKU



SHAMIA — SIMBOL, DETYRIM DHE TEST

Le ta dinë këta (imituesit injorantë), se janë duke bërë dy gabime. Gabimi i parë është mosdallimi mes shamisë dhe ferexesë, ndërsa i dyti krahasimi mes atyre vendeve dhe vendit tonë, në të cilin përkatësia islame e tejkalon 90 për qindëshin.

SHKRUAN: EKREM AVDIU

Jemi dëshmitarë të zhvillimeve të fundit në Kosovë që kulmuan me një shqetësim shumë të madh në radhët e komunitetit

fetar musliman e që ka të bëjë me udhëzimin administrativ të lëshuar nga MASHT-i për ndalesën e mbajtjes së shamisë (mbulesës islame) në shkollat publike. Ky shqetësim ka rezultuar me një protestë masive të mbajtur në Prishtinë e

që kishte si qëllim shprehjen e pakënaqësisë me këtë vendim. Një gjë interesante që e karakterizoi protestën ishte një maturi e skajshme e protestuesve, ndërsa organizatori u kujdes që edhe shishet plastike të ujit që kishin pirë protestuesit në atë ditë me vapë të mos mbeteshin në rrugë, duke treguar me këtë një kulturë që nuk e hasim edhe në shoqëritë më të ngritura.

Shamia dhe kodi i mirësjelljes

Kam thënë në një prononcim publik, se nëse hartuesit e kësaj politike të gabuar përballë mbulesës islame janë inspiruar për vendimin e tyre nga vendimi që kanë ndërmarrë disa vende evropiane për të ndaluar mbulimin e fytyrës në vende publike, le ta dinë këta (imituesit injorantë), se janë duke bërë dy gabime. Gabimi i parë është mosdallimi mes shamisë dhe ferexhesë, ndërsa i dyti krahasimi mes atyre vendeve dhe vendit tonë, në të cilin përkatësia islame e tejkalon 90 për qindëshin.

Në anën tjetër udhëzimi i MASHT-it e në të cilin ndalohet mbulesa ka të bëjë me kodin e mirësjelljes së nxënësve në shkolla, me ç'rast definohet se nxënësit nuk duhet të mbajnë në shkollë gjëra të ndaluara dhe të rrezikshme, si armët e zjarrit dhe ato të ftohta dhe nuk duhet të mbajnë edhe shaminë e kokës. Shumë ironike se si është kujdesur hartuesi, që edhe mbulesa e vajzave muslimane të listohet në rendin e gjërave të rrezikshme, të cilat e prishin rendin e mirësjelljes nëpër shkolla. Ndërsa realiteti i pamohueshëm ka dëshmuar se ato vajza, por edhe djemtë që njihen si praktikues të fesë janë nxënësit më të dalluar, si në sjellje ashtu edhe në mësim.

Ky kufizim për sa i përket veshjes në

“...Muslimanët e Kosovës duhet të ngrenë kolektivisht padi kundër atyre që aplikojnë vendime të tilla, nëse ka nevojë edhe në gjykatat ndërkombëtare të drejtësisë...”

shkollat publike derisa vërehet se është i njëanshëm, ngaqë kufizon vetëm “tepricën” e rrobave (e që çdo i mençur e di se ato kurrë nuk janë tepër), ndërsa nga ana tjetër nuk e kufizon “pakicën” e tyre, është treguesi më i mirë se këtu kemi të bëjmë me shkelje flagrante të të drejtave dhe lirive të njeriut në tentativë dhe muslimanët e Kosovës duhet të ngrenë kolektivisht padi kundër atyre që aplikojnë vendime të tilla, nëse ka nevojë edhe në gjykatat ndërkombëtare të drejtësisë. Ndërsa shkollat publike janë pronë e të gjithëve, ngaqë janë ngritur dhe financohen me paratë e të gjithëve, prandaj nuk ka të drejtë askush, qoftë ai edhe ministri i arsimit apo edhe kryetari i qeverisë, që t’ua ndalojë shkollimin atyre që kanë hise në ato shkolla, derisa këta nuk bëjnë asgjë të kundërligjshme, ndërsa mënyra islame e veshjes në asnjë mënyrë nuk mund të jetë e kundërligjshme.

Gjatë debatit është thënë se simbolet fetare nuk e kanë vendin në shkolla publike, në anën tjetër muslimanët thonë se shamia dhe mbulesa nuk është simbol, por është detyrim fetar nëpërmjet kryerjes së të cilit, femra muslimane arrin lirinë e besimit dhe të nënshtrimit ndaj Allahut. Unë mendoj se polemika të këtilla nuk

“Në një moment plakut i mbushën sytë me lot dhe derisa po hynte në xhami bëri një lutje: Ah, Allahu iu ardhte hakut! ...”

sjellin ndonjë fryt, ngaqë sido që ta quajmë, dikush prapë do të mundohet që ta ndalojë. Por ajo që mund të lexohet mes rreshtave, është se ky është një test shumë i rëndësishëm për komunitetin musliman e që ka të bëjë me besnikërinë e tij ndaj identitetit, me ç'rast duhet të dihet se çfarëdo lëshimi të bëhet në këtë drejtim paraqet rrezik për shkrirje të plotë, ngase në këtë drejtim kjo është vija e fundit mbrojtëse, e cila nëse bie, pas saj nuk mbetet gjë e vlefshme për të ruajtur. Historia e afërt, e kohës së pas Luftës së Dytë Botërore është dëshmitari më i mirë për këtë, prandaj kushdo që do të merret me këtë problematikë duhet të jetë i vetëdijshëm për ndjeshmërinë e saj.

Raporti i DASH-it për prostitucionin dhe trafikimin e njerëzve

Ishte shumë nënçmuese për çdo kosovar të marri vesh se raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit përmend se Kosova në njëfarë mënyre është ngritur bukur shumë në listën e vendeve në të cilat është i zhvilluar prostitucioni dhe trafikimi i qenieve njerëzore. Për ata që mund të bëjnë diçka për të ndaluar dhe penguar një gjë të tillë kjo duhet të jetë një shqetësim dhe një detyrim, që të ndërmerren hapa konkretë për të penguar dukuri të kësilla. Megjithatë do të ishte e padrejtë sikur të mos e pranoni se gjëra të kësilla ndodhin

në shumë vende. Ajo që ia shton ironinë këtij lajmi është fakti se ka ndodhur mu në kohën kur zhvillohej debati rreth shamisë në Kosovë. Mu për këtë, nuk më habiti ajo që pashë në një nga TV-të lokale ndërkohë që intervistoheshin njerëzit e një numër i madh i tyre thoshin duke e formuluar secili sipas mënyrës së vet: Ja, shihe me çfarë merren qeveritarët (duke aluduar në mbulesën islame) e me çka duhet të merren (duke dhënë shenjë në këtë raport).

Muslimanët, çka më tutje?

Një ditë xhumaje ndërsa po hyja në xhami më ndali një i moshuar për të pyetur rreth këtyre zhvillimeve. Biseda jonë më tepër mori kahen e të shprehurit të mllefrit dhe indinjatës, se sa që kishim çka të komentoni konkretisht. Në një moment plakut i mbushën sytë me lot dhe derisa po hynte në xhami bëri një lutje: Ah, Allahu iu ardhte hakut! Me të dëgjuar këtë mallkim ndjeva nevojën të dëshiroj, që kurrën e kurrës dikush për mua të lutet kësisoj. Në të njëjtën kohë m'u kujtua se lutjet e njerëzve që janë në zor, atyre që iu është bërë e padrejtësi janë prioritare për të qenë të pranuar dhe të dëgjuara tek Allahu. Por si do të jetë halli i zullumqarëve, se?!...

Muslimanët u tubuan në një protestë për të shprehur pakënaqësitë e tyre. Ky ishte vetëm një hap, uroj të mos jetë i fundit. Mjetet demokratike të presionit janë të shumta dhe të llojllojshme, duke filluar nga kjo e duke vazhduar me debate e sensibilizim të opinionit, për të kaluar në peticione dhe inicime të padive në gjykatat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Gjithsesi, duke mos e harruar atë lutjen e plakut me sy të përplotur. ■



VERA MES PROVËS DHE SPROVËS

Për të gjithë ata, që deri dje nuk kanë qenë ashtu siç duhet korrekt me faljen, adhurimin, prezantimin në mësim apo ligjërata, që janë arsyetuar se s'kemi kohë, jemi të zënë etj... etj...

SHKRUAN: AHMED KALAJA

Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshëm, Mëshiruesit; Allahun e falënderojmë, që na bëri neve dhuratën më të çmuar Islamit, si fenë e vetme të pranuar. Allahu vendosi rregulla dhe ligje, që e bëjnë atë aktuale dhe të përshtatshme për çdo kohë dhe çdo vend, të asimilueshme për çdo natyrë njerëzore, gjithëpërfshirëse në vetvete të çdo skaji tokësor dhe kohor.

Islami që me hijen e Tij të rëndë nënkupton nështrimin absolut ndaj Absolutit, të udhëhequr me dashuri ka trajtuar me imtësi shumë detaje, të cilat e

bëjnë një mozaik të shumëllojshëm ngjyrash të pranueshëm për çdo ambient e të përshtatshëm për çdo shpirt qetësues prehës. **“Ne në Libër çdo gjë e kemi Trajtuar”**. Trajtimi i jetës në tërësi nuk do të thotë mos të trajtojë detajet e saj, që pa to do të mbetej i mangët trajtimi. Pjesë e këtij trajtimi është viti në tërësi me të gjitha copëzat e veta, duke përfshirë këtu edhe verën, si stinën e muajve të “relaksit” dhe të pushimeve.

Së pari, gjëja e parë që na sjell në mendje vera është Fuqia, Urtësia, Dituria e të Gjithëfuqishmit, Plotfuqishmit, Gjithëpushtetshmit, Gjithëditurit, Gjithëdëgjuesit, Gjithëshikuesit, që e ndërtoi jetën në tokë dhe e orientoi në

mënyrë të atillë, që të përbëhet nga sekondat e deri te shekujt e kështu duke i përshtatur asaj gjithçka është në qiej e në tokë, ndërsa faktori kohë Zotin nuk e përfshin për të vetmin fakt se është krijesë e si pasojë s'e përfshin Krijuesin e saj.

Në ndryshimin e ditëve, javëve muajve, stinëve, viteve ka argumente të qarta për njerëzit e mençur, që të kuptojnë se konstantja nuk ekziston dhe çdo gjë është në lëvizje e sipër, po kështu edhe njeriu në besimin e tij s'ka stabilitet, apo konstante. Ai po nuk shkoi lart shkon drejt rënies.

Argumente të qarta se pas kësaj ekzistence qëndron një krijues që i di “punët“ e Tij më mirë se çdokush tjetër dhe se njerëzit sado që të mundohen, apo të dëshirojnë të kenë sado pak pushtet mbi botën dhe universin ata mbeten tepër të dobët përpara pushtetit dhe urtësisë së Zotit, sepse po të ishte për njeriun do ta priste shumë shkurt, duke dashur që koha të ishte vazhdimisht pranverë. Po, a e mendon njeriu vetë, se çdo të ndodhte po të ishte vetëm pranverë?

Së dyti, është e nevojshme, ose domosdoshmëri funksionimi i stinëve në tërësi, po edhe i verës në veçanti, sepse në të ndodhin shumë procese dhe zhvillime, që s'mund të ndodhin veçse me funksionimin e saj të plotë si stinë.

Së treti, njeriu duhet të kuptojë se jeta vazhdon me të ose pa të dhe kështu do të zhvillohet dhe do të vazhdojë, kështu që o njeri, mos kujto se bota rrotullohet rreth teje, ka një bosht tjetër koha dhe toka.

Së katërti, dobësia e njeriut përpara madhësisë së Krijuesit, pra, ndodh ç'ndodh në këtë univers nëpër oqeanet e galaktikave, nëpër detet e sistemeve diellore e njeriu qëndron i habitur se si e përfshiu edhe atë rrëkeja e jetës.

Së pesti, dhe që është më e rëndësishmja që unë mendoj është, se ty o

“Ti je edhe punëtori, edhe furnitori, edhe ruajtësi, kështu që zullum s'do të të bëjë Gjykatësi...”

njeri për çdo çast, sekondë, minutë, orë, ditë, natë, javë, muaj e vit po të jepet një këshillë e vazhdueshme, po humb vazhdimisht nga jeta, po i afroresh për çdo moment Botës Tjetër. A po përgatitesh, sepse çdo çast dhe moment i jetës më shumë apo më pak janë pikërisht hambaret, rezervuaret që të janë lënë me qira për t'i shfrytëzuar sa je gjallë. Mos të jesh në atë botë prej atyre që kur t'ju hapen hambarët do t'i gjejnë bosh; kur t'ju hapen hambarët do t'i gjejnë me rezerva të prishura, ose të skaduara, ose të dëmshme. Ti je edhe punëtori, edhe furnitori, edhe ruajtësi, kështu që zullum s'do të të bëjë Gjykatësi.

Së gjashti, dhe që është tepër e rëndësishme për besimtarin është se e kujton me zjarrin e xhehenemit, me ferrin, sepse nëse njeriu nuk e duron dot këtë temperaturë në këtë botë, atëherë si do të durojë zjarrin e Xhehenemit, dhe se xhehenemi nuk ekziston në formë abstrakte, por realisht dhe faktikisht, madje me pasoja; dëgjoje këtë hadith profetik: “Xhehenemi iu ankua Zotit duke i thënë: “O Zoti im, prej nxehtësisë së madhe dhe forcës djegëse po vetëdigjem e po vetëtretem.” Allahu e lejoi të shfrynte dy herë, është pikërisht i nxehti më i madh dhe i ftohti më i madh”. Xhehenemi është më i fuqishëm 70-fish, se sa të gjitha zjarret që janë parë mbi sipërfaqen e tokës, duke përfshirë këtu dhe llavën vullkanike dhe djegiet kimike të çdo lloji tjetër, qysh nga momenti i krijimit të qiejve dhe tokës.

I nxehti më i madh e kuptojmë, po i ftohti ç'ne? Ferri, xhehenemi është vend i specializur në fushën e djegieve, kështu që prej formave dhe mënyrave të djegies në Skëterrë është edhe djegia me ftohje. Allahu na ruajtë!

Vera funksionoka edhe si qortues për njeriun, se a je i vetëdijshtëm që çfarë po ndodh, se kujt po i afroresh dhe se kujt realisht po i largohesh, dhe se në çdo moment njeriu vetem se i afrohet, dhe vera duhet të të kujtojë pikërisht për këtë gjë.

Vera shërben si provë dhe si sprovë. Si? Vera si provë?

Për të gjithë ata, që deri dje nuk kanë qenë ashtu siç duhet korrekt me faljen, adhurimin, prezantimin në mësim apo ligjëratat, që janë arsyetuar se s'kemi kohë, jemi të zënë etj... etj...

Për të gjithë ata që duan të tregojnë së me të vërtetë janë arsyetuar kur faljes s'i dhanë atë që meritonte, agjërimit s'i dhanë atë që meritonte, për të gjithë ata që deri më sot akoma e lexojnë Kuranin jo në gjuhën në të cilën e zbriti Allahu, për të gjithë ata që te Zoti s'janë penduar siç duhet, për të gjithë ata që farefisit të tyre s'i kanë dhënë hakun dhe s'i kane vizituar tani në verë janë në provë.

“Pasha Zotin e gjithësisë degjenerimi në veshje ka arritur kulmin, saqë ndonjëra prej tyre kur shkon në shtratin e vet për të fjetur gjumë me bashkëshortin e saj vishet më shumë dhe e mbulon më shumë trupin e saj...”

Vera sprovë?

Ajo është sprovë për të gjithë burrat, që të ruajnë shikimet e tyre dhe t'i ulin, sepse pasha Zotin e gjithësisë degjenerimi në veshje ka arritur kulmin, saqë ndonjëra prej tyre kur shkon në shtratin e vet për të fjetur gjumë me bashkëshortin e saj vishet më shumë dhe e mbulon më shumë trupin e saj. Kujdes, sepse djalli në verë punon më shumë, prandaj nuk mund të ruhet njeriu prej imoralitetit direkt, po duhet që të presë të gjitha rrugët që të çojnë në atë përfundim të kobshëm, Allahu na ruajtë.

Sprovë për gratë, që të ruajnë dhe ulin shikimet e tyre nga shikimi i meshkujve, sepse do të ndodhë e kundërta dhe e pakta gjë ftohje nga jeta bashkëshortore dhe muri ka keq sa të fillojë krisjen. Pra, jo vetëm burrat po edhe gratë në këtë drejtim janë njësoj, për këtë arsye Allahu i drejtohet për të ulur shikimin besimtarëve dhe besimtareve: **“Thuaji besimtarëve t'i ulin shikimet e tyre...”**. Muhamedi *alejhi selam* kur na paralajmëron se: **“Shikimi është prej shigjetave të helmuara të djallit.”**, pra, ai, *alejhi selam*, nuk bën dallim mes mashkullit dhe femrës. Çdo shikim që plotëson kriteret te gjinia tjetër përfshihet në hadith. Faktin gjinia tjetër e theksoj, sepse tek e njëjta gjini ky lloj shikimi quhet në gjuhën e fesë një hap për të dalë nga njerëzorja, pasi në fe kontakti me të njëjtin seks konsiderohet dalje prej njerëzores, njësim me kafshëroren gjë për të cilën Zoti i dënoi popujt përpara nesh.

Sprovë për baballarët dhe vëllezërit, që mos t'i përfshijë thënia e Muhamedit *alejhi selam*: **“Tre kategori njerëzish s'do të futen në xhenet, as nuk do t'ia ndejnë erën se si e ka... dhe dejuthi.”** Shokët e tij i thanë: O Profet i Zotit, po dejuth çdo të thotë.- Ai iu përgjigjet: **“Të hetosh depërtimin e imoralitetit në familje dhe të hezitosh në ndalimin e tij.”** Allahu na ruajtë!

“Feja Islame është një fe e gjallë dhe dinamike, e cila e ka trajtuar argëtimin dhe lojën si një pjesë të pandarë të konceptimit të jetës normale të njeriut...”

Për stinën e verës ka edhe diçka shumë me rëndësi që duhet t'i kushtojmë rëndësi është faktori i argëtimit, si domosdoshmëri për një jetë sa më të mirë dhe me besim sa më të pjekur. Feja Islame është një fe e gjallë dhe dinamike, e cila e ka trajtuar argëtimin dhe lojën si një pjesë të pandarë të konceptimit të jetës normale të njeriut, pra d.m.th., se ti je adhurues i Zotit s'do të thotë kjo që s'duhet të lozësh apo të argëtohesh, përkundrazi i Dashuri i Allahut dhe i Dërguari i tij *sal-lAllahu alejhi ue selem*, ka lozur me shokët e vet, ka bërë gara, dhe jo vetëm kaq, por na ka këshilluar edhe neve të jemi të tillë dhe na i ka lënë për detyrë disa sporte: *“Hipizmin, notin dhe marrjen në nishan”*.

Porosia është: *“Besimtari i fortë dhe i fuqishëm është më i mirë dhe më i dashur te Zoti, se ai që është i dobët, sepse në të ka dy mirësi.”* Pra, nëse bashkohen te një person fuqia e besimit me forcën e trupit është më mirë, sepse është më i dobishëm për veten dhe shoqërinë e tij.

Kështu që stina e verës duhet shfrytëzuar në këtë aspekt, që familja të argëtohen, fëmijët të lozin, t'i ndejnë sa më shumë këto pushime verore, se pastaj vjen një vit i tendosur nën trysinë e jetës dhe tensionet e saj, dhe ndoshta nuk i ke mundësitë për t'ju përkushtuar familjes siç duhet, atëherë vera është një argument se

ti me të vërtetë je i zënë jo se nuk do.

Vera qenka me gjithë këto të mira, por ka edhe diçka tjetër që s'duhet lënë pas dore dhe nuk duhet ta harrojmë. Vera e këtij viti është dhe vetë vigjilja e Ramazanit, meqë Ramazani edhe këtë vit si dhe vitin e ardhshëm i bie ta shijojmë në verë, kështu që vera duhet të shërbejë edhe për parapërgatitje për Ramazanin, që të agjërojmë disa ditë dhe kohë, sepse do të jetë dhe më e lehtë kur të vijë muaji i bekuar i agjërimin, Allahu na e mundësoftë agjërimin e tij me dinjitet; Amin! Kujto sahabin e nderuar Muadh ibën Xhebelin, i cili filloi të qante në shtratin e vdekjes e kur i thanë: Pse po qan?- Ai tha: Qaj për tre gjëra, që s'do të mund t'i bëj dot më. Agjërimin e ditëve të nxehta, faljen gjatë natës dhe t'i përthyej gjunjë para dijetarëve.

Vella dhe motër besimtare, shfrytëzoje këtë verë dhe bëje shkak që të fitosh xhenetin dhe të shpëtosh prej xhehenemit. Allahu më ruajtë mua dhe ty, dhe të gjithë besimtarët dhe besimtare nga Zjarri i xhehenemit. Amin. Le të jetë vera jote këtë vit shkak që të shtohen shpërblimet; le të jetë motoja jonë këtë vit, në verën e sivjetshme ajeti i sures Bekare, nr. 197: ***“Përgatituni për në botën Tjetër, duke bërë sa më shumë vepra të mira, sepse ato janë zahireja e ahiretit!”*** Ngaqë asnjëri prej nesh s'ka garanci, se: a do të ketë mundësi ta mbarojë këtë verë, apo jo?!... Te mëshira Jote, Zoti ynë, i kemi të gjitha shpresat. Ti je i Mëshirshëm dhe shumë falës, na fal dhe na mëshiro! Familjet, miqtë dhe të dashurit në Islam na i udhëzo! Amin! Amin! Amin! Ue elhamdulilahi rabil alemin! ■



ÇFARË BËNI KUR SHKONI NË DET...?

ISA HASEN EDH DHEJAB

Falënderimi i takon vetëm Allahut, paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të Dërguarin e Tij, familjen, shokët dhe të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij. Është bërë traditë e shumë personave që gjatë verës të shkojnë në det, disa për peshkim e të tjerët për

pushime (shëtitje), edhe pse ekzistojnë rregulla e dispozita konkrete për ata që synojnë detin. Ndokush nga padituria e shumëkush nga moskujdesja nuk i veprojnë ato. Nisur nga kjo kam vendosur që në këtë shkrim të ofroj disa nga rregullat dhe sjelljet e çdokujt që dëshiron të udhëtojë për në det.

Së pari: dispozitat e atyre që lundrojnë në det:

Lutja kur të hipet në mjetin e udhëtimit (barkë, anije):

“Me emrin e Allahut, falënderimi i takon Allahut, i Lartmadhërishëm qoftë Ai që i nënshtroi këto për ne, sepse ne nuk do të kishim mundësi ta bënim këtë. Ne, me të vërtetë, te Zoti ynë do të kthehemi.” Pastaj thotë: “Falënderimi i takon Allahut (tri herë), Allahu është më i madhi (tri herë)”. E pastaj lexon: “I Lartë qofsh, o Zoti im! Unë i kam bërë dëm (zullum) vetvetes, prandaj më fal mua, sepse askush përveç teje nuk mund t’i falë mëkatet!”. Shënon Ahmed i dhe Ehlu Sunen.

Lutja me rastin e zbarkimit në ndonjë ishull:

“Kush zbret në ndonjë vend e thotë: “Kërkoj mbrojtje me fjalët e plota të Allahut nga të këqijat që ka krijuar.”, nuk i bën dëm atij asgjë, derisa të largohet nga ai vend.” Shënon Muslimi .

Thirrja për namaz (ezani) në det:

Ebu Seid el Hudriu na përcjell se Pejgamberi, *sal-lAllahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Çdo xhind apo njeri që e dëgjon zërin e muezinit, do të dëshmojë për të në Ditën e Kiametit.” (Buhariu), kurse në transmetimin e Ibën Maxhes qëndron: “...çdo gur dhe dru do të dëshmojë për muezinin”. Në hadithin tjetër të përcjellë nga Ibën Omeri thuhet se Pejgamberi, *sal-lAllahu alejhi ue selem*, ka thënë: “I falen mëkatet muezinit sado që të dëgjohet zëri i tij, dhe për të lutet çdo gjë e ngurtë dhe e thatë.” Albani ka thënë se hadithi është i vërtetë. Nëse gjatë udhëtimit është vetëm një person, atëherë nuk e ka detyrim thirrjen e ezanit e as të ikametit, por që të dyja janë sunete për të, ndërsa kur udhëtojnë dy persona e më tepër e kanë për detyrë thirrjen e ezanit dhe të ikametit nga

“Çdo xhind apo njeri që e dëgjon zërin e muezinit, do të dëshmojë për të në Ditën e Kiametit ...”

fjala e Pejgamberit, *sal-lAllahu alejhi ue selem*: “Nëse ju të dy gjendeni në udhëtim, thirrreni ezanin pastaj ikametin.” (Buhariu dhe Muslimi). Pra, ezani është detyrim vetëm për burrat kur falen në grup (xhemat), ndërsa nuk është detyrim ndaj grave, por ndaj tyre është i preferuar vetëm ikameti.

Kërkimi i kibles për namaz gjatë udhëtimit në det:

Është detyrim i kujtdo që dëshiron të falet ta hulumtojë drejtimin e kibles dhe të orientohet andej, ngaqë Pejgamberi, *sal-lAllahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Kur të ngrihesh për namaz plotësoje abdesin, drejtohu nga kibra dhe thuaj Allahu Ekber.” (Buhariu dhe Muslimi).

- Nëse dikush falet pa u mundua fare ta gjejë drejtimin e kibles dhe pastaj vërtetohet se ka qenë gabim, ai duhet ta përsëritë atë namaz.

- Nëse falet pa u mundua fare ta gjejë drejtimin e kibles dhe pastaj vërtetohet se ia ka qëlluar, namazi i tij është në rregull (sipas mendimit më të saktë të dijetarëve).

- Nëse kërkon drejtimin e kibles dhe falet në drejtimin e asaj që është më i sigurt, dhe pas namazit e kupton se nuk është falur në drejtimin e duhur, namazi i tij është i saktë, për faktin se është falur në drejtim të asaj që kishte arritur me hulumtimin e tij për kiblen, gjë me të cilën edhe është i detyruar nga Allahu. Mu për këtë rekomandohet, që gjatë udhëtimit në det të kesh edhe një busull për gjetjen e kibles.

Qëndrimi në këmbë gjatë namazit:

Në namazet farz është i detyrueshëm qëndrimi në këmbë, duke u bazuar në fjalën e Allahut dhe në hadithin e Pejgamberit, *sal-Allahu alejhi ue selem*: “Falu në këmbë, nëse nuk mundesh falu ulur, e nëse nuk mundesh, atëherë falu shtrirë në krah.” (Buhariu). Qëndrimi në këmbë kërkohet goftë edhe duke u mbështetur në ndonjë shkop, litar apo mur, vetëm në rast rreziku të jetës dhe shëndetit nga qëndrimi në këmbë, atëherë lejohet falja ulur. Ndërsa në namazet nafile (vullnetare) qëndrimi në këmbë nuk është i detyruar edhe po të jetë i mundur, ngaqë kështu ishte tradita e Pejgamberit, *sal-Allahu alejhi ue selem*, kur udhëtonte; ai i falte namazet nafile ndërsa ishte i hipur mbi deve, kurse për faljen e farzeve zbriste poshtë, për shkak se nuk mund të qëndrohet në këmbë mbi deve.

A është e lejuar falja e namazit pas safit (rreshtit) nëse nuk gjen vend në saf?

Në thelb nuk lejohet falja pas safit, por duhet të falemi të gjithë së bashku në safe, ashtu siç transmetohet në hadith: “Nuk ka namaz ai që falet pas safit vetëm.” (Albani ka thënë: i vërtetë), mirëpo lejohet namazi pas safit, atëherë kur nuk mbetet hapësirë në saf dhe i detyruar nga kjo gjendje duhet të falet edhe në këtë formë dhe namazi i tij është në rregull inshalla.

Mbulimi i avretit gjatë faljes:

Falësi duhet t’i mbulojë pjesët e tij të turpshme gjatë namazit, nga fjala e Allahut: “O Bijtë e Ademit! Vishni stolitë tuaja (petkun më të mirë e më të pastër) **kur faleni.**” (Araf 31). Pjesë të turpshme për burrat llogariten nga kërthiza e deri tek gjunjët, të cilat duhet mbuluar doemos gjatë namazit. Rrobat me të cilat mbulohet trupi duhet të mos jenë të tejdukshme, por ta mbulojnë trupin derisa të mos dallohet

ngjyra e lëkurës, e në rast se dikush falet me rroba nga të cilat shihet qartazi ngjyra e lëkurës namazi i tij nuk është në rregull.

Falja e namazit me shorce:

Nuk lejohet falja e namazit me rroba të shkurtra që nuk i mbulojnë gjunjët, ngaqë në këtë formë është turp të dilet para Allahut, Mbretit të mbretërve.

Falja e namazit të xhumasë në anije:

Namazi i xhumasë është detyrim për ata persona që nuk janë në udhëtim, kurse ata që gjenden në det llogariten si udhëtarë dhe nuk e falin xhumanë por në vend të saj falin drekën.

Abdesi dhe pastrimi (gusli) me ujin e detit:

Uji i detit është i pastër në vetvete, pastrues për të tjerët, ashtu siç ka thënë Pejgamberi, *sal-Allahu alejhi ue selem*, për detin: “Uji i tij është i pastër dhe të ngordhurat e tij janë hallall.” (Albani ka thënë hadithi është i saktë). Pra, nga kjo kuptohet, se lejohet marrja abdes dhe pastrimi me ujin e detit.

Dispozitat e gjallesave të detit (gjarpri, akrepi, qeni, egërsirat, krokodilët, breshkat etj):

Të gjitha krijesat e detit janë të lejuara për ngrënie pavarësisht nëse janë në formë njeriu, egërsire, gjarpri, apo në formë qeni, bretkose, krokodili, breshke etj., duke u bazuar në përgjithësimin e argumenteve për këto gjëra, si p.sh. fjala e Allahut: “**E lejuar për ju është gjuetia** (e kafshëve) **ujore dhe përdorimi i tyre si ushqim.**” (Maide 96), si dhe hadithi i sipërcituar se: “Uji i tij është i pastër dhe të ngordhurat e tij janë hallall”.

Së dyti: Disa dispozita për ata që gjinden në bregdet.

Leximi i lutjes me rastin e arritjes në det:

“Kërkoj mbrojtje me fjalët e plota të Allahut nga të këqijat që ka krijuar.”

Vendosja e ndonjë sendi në vendin e sexhdes nëse toka është e nxehtë.

Siç tregon Enesi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se ishin duke u falur me të Dërguarin e Allahut, *sal-IAllahu alejhi ue selem*, dhe dikush nga ne vendoste pjesë nga rrobat e tij në vendin e sexhdes për shkak të nxehtësisë së lartë.” (Muslimi).

Preferimi i vonimit të namazit të drekës:

Në muajt e verës shpesh arrihen temperatura të larta, dhe sidomos në kohën kur dielli është në zenit, pra në kohën e namazit të drekës, por edhe në këtë rast Islami nuk i ka lënë pjesëtarët e tij pa rrugëzgjdhje, duke iu mundësuar atyre kështu shtyrjen e drekës derisa të freskohet pakëz. Në hadithin e shënuar nga Buhariu dhe Muslimi, Pejgamberi, *sal-IAllahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Shtyni (vononi) drekën derisa të zbutet nxehtësia, se me të vërtetë vapa e lartë është prej nxehtësisë së Xhehenemit”.

Falja e namazit mbathur me sandale:

Pejgamberi, *sal-IAllahu alejhi ue selem*, në lidhje me faljen e namazit mbathur ka thënë: “Kundërshtoni (dallohuni) çifutët, sepse ata nuk falen mbathur.”, (Albani ka thënë hadithi është i saktë), dhe në hadithin tjetër qëndron: “Kur dikush nga ju falet, le t’i mbathë sandalet e tij, apo le t’i vendosë ato në mes të këmbëve të tij, duke mos e dëmtuar vëllanë e tij.” (Albani ka thënë është i saktë). Namazi mbathur është sunet, atëherë kur vërtetohet pastërtia e tyre, e nëse ato përmbajnë ndyrësira duhet zbatuar detyrimisht. ■

Përshtati: Fazli BUNJAKU

MURABAHA

Ata që thonë se murabaha është njësoj si kamata dhe se bankat islame janë si ato konvencionale, kjo thënie nuk është e re, kështu thoshin edhe idhujtarët: shitblerja është njësoj si kamata



SHKRUAN: LLOKMAN HOXHA

Murabaha është një ndër transaksionet e shumta të bankës islame. Ajo është një transaksion i ri për fikhun islam për nga praktika, porse burimi i saj gjendet në librat e fikhut të dijetarëve të hershëm.

Së pari, na duhet të sqarojmë bazën e këtij transaksioni, murabahanë (e thjeshtë) në fikh pastaj të shtjellojmë praktikën bashkëkohore bankare të kësaj çështje. Murabaha bënë pjesë në llojin e shitblerjeve

dhe është ajo shitblerje ku dihet çmimi i parë i mallit dhe mbi të ndërtohet një fitim i caktuar. Pra kjo shitblerje bazohet në besueshmëri, meqë kushtëzohet njoftimi i blerësit me çmimin e produktit, pra shitësi thotë: Ky produkt, mua më ka kushtuar 100€ dhe unë ta shes ty me 12€ fitim, pra gjithsej 112 €.

Kjo shitblerje është e lejuar me konsensusin e dijetarëve dhe nuk dihet që dikush ta ketë kundërshtuar një gjë të tillë. Nevoja për këtë shitblerje vjen në shprehje kur blerësi nuk e njeh tregun dhe ai ka besim tek ndonjë tregtar, që ta blejë mallin prej tij, me një fitim të caktuar mbi sasinë e çmimit të parë. Pra, kjo shitblerje është e lidhur ngushtë me besnikërinë dhe transparencën.

Murabaha me porosi (ashtu si zhvillohet në bankat islame)

Ndryshe quhet edhe **“murabaha për atë që urdhëron blerjen”** ose **“për atë që premtun blerjen”**.

Është ajo shitblerje ku dy persona apo më shumë pajtohen për ta zbatuar një kontratë në të cilën kërkohet nga i urdhëruari (banka) të blejë për urdhëruesin (porositësin) një produkt të caktuar, ose të përshkruar me specifika të veçanta, duke premtuar se do ta blejë prej tij (bankës) me një fitim të caktuar sipas marrëveshjes me anë të një kontrate të re për shitblerjen e dytë.

Shembull praktik:

1. klienti shkon në bankë për të lidhur një kontratë për blerjen e një veture nga një sallon i caktuar,

2. klienti i thotë bankës unë dua të blej këtë veturë me këto tipare, por nuk kam kapital për këtë, nëse ju e blini me çmimin, i cili shitet në sallon, atëherë unë ju **premtoj** se do ta blej nga ju me një fitim sipas marrëveshjes në këste të ndara deri në afatin e caktuar,

3. atëherë banka e blen veturën dhe e bën pronë të vetën,

4. pastaj ia shet klientin me një kontratë të re sipas marrëveshjes.

Po ashtu ky transaksion i kombinuar nga më shumë se një kontratë është i lejuar tek të gjithë dijetarët bashkëkohorë në përgjithësi përveç disa dallimeve mes tyre në disa detaje dhe kushte në praktikën e këtij transaksioni.

E thënë më saktë mospajtimi ka të bëjë me premtimin e klientit ndaj bankës, a është i detyrueshëm apo jo, pra, pasi klienti e porosit produktin e caktuar nga banka dhe i premtton bankës se do ta blejë prej saj me një fitim të caktuar, a është klienti i detyruar ta zbatojë këtë premtim apo është i lirë të mos e plotësojë kontratën.

Për këtë në vijim do të sqarojmë dispozitën e premtimit a konsiderohet detyrim apo jo.

Sipas pjesës më të madhe të dijetarëve zbatimi i premtimit është vepër e pëlqyer, por jo e detyrueshme, ose e thënë më saktë detyrueshmëria e zbatimit është nga aspekti fetar dhe moral, por është një gjë që nuk detyrohet me gjyq, sepse premtimi në esencë është diçka vullnetare, ndërsa kontratat vullnetare nuk detyrohen përveçse pas marrjes së asaj që jepet vullnetarisht, po ashtu premtimi nuk

“Murabaha është këmbim i produktit me para, kurse krediti është këmbim i parave me para shtesë...”

bëhet i detyrueshëm pas marrjes së asaj që është premtuar. Pra, nëse pas premtimit, dhe para se të zbatohet ajo që është premtuar, premtuesi e tërheq premtimin e vet, nuk detyrohet gjyqësisht të zbatojë premtimin, por nëse pas premtimit e ka zbatuar premtimin, atëherë tërheqja është e pavlefshme, sepse në këtë rast premtimi zbatohet detyrimisht.

P.sh., nëse klienti e porosit bankën për një produkt, dhe pasi ta ketë blerë banka produktin dhe ta ketë pronësuar atë, atëherë sipas shumicës së dijetarëve klienti nuk është i detyruar gjyqësisht ta blejë produktin nga banka, edhe pse i ka premtuar, sepse premtimi nuk është i detyrueshëm, por nëse e blen prej bankës, atëherë nuk ka të drejtë ta anulojë kontratën, sepse tashmë është zbatuar premtimi.

Ndërsa dijetarët e medhhebit maliki kanë dhënë një sqarim më të hollësishëm për premtimin, që nëse gjëja e premtuar bëhet për shkak të premtimit të asaj gjëje, atëherë premtuesi detyrohet të zbatojë premtimin moralisht dhe gjyqësisht, si t'i thotë dikujt: martohu se unë ta paguaj dasmën, ose rrënoje shtëpinë se unë ta jap banesën time, ose bli një veturë se unë e blej prej teje etj, d.m.th personi e bën veprimin për shkak të premtimit nga pala tjetër, palë e cila i ka premtuar konkretisht për çështjen në fjalë, për ndryshe nuk do ta kishte bërë atë veprim, atëherë për derisa premtuesi e fut në lojë

tjetrin, atëherë duhet ta nxjerrë nga ajo, por nëse i thotë: të premtoj se do të jap 1000€, por pa treguar shkakun dhe ai martohet ose blen veturë duke u bazuar në premtim, ndërsa kur vjen koha e pagesës, premtuesi ndërron mendimin, pra, premtuesi nuk e ka futur në lojë, por ai vetë e ka planifikuar një gjë të tillë në bazë të premtimit, kjo sipas shumicës së dijetarëve nuk e detyron premtuesin me asgjë gjyqësisht përveç anës morale dhe fetare në kuptimin e ndëshkimit për moszbatimin e premtimit, siç është theksuar në ajete dhe hadithe, të cilat bëjnë të detyrueshme mbajtjen e premtimit.

Këtë mendim e ka përkrahur Akademia e Fikhut Islam, që premtimi duhet zbatuar fetarisht përveç me ndonjë arsye, si dhe detyrohet zbatimi gjyqësisht në rast se premtimi është i varur nga shkakun dhe ka lidhje direkt me çështjen e premtuar, pra gjëja e premtuar vjen si rezultat i premtimit, si dhe mos-zbatimi duhet të shpaguehet me vlerën reale të dëmtimit të palës, përveç me arsye shariatike.

Rregullat dhe kushtet, të cilat duhet t'i plotësojë kontrata e murabahas me porosi:

1. Pronësimi i mallit nga banka para se t'ia shesë klientit (porositësit).
2. Banka duhet të mbajë përgjegjësinë e humbjes (shkatërrimit) së mallit, përderisa nuk i është dorëzuar klientit.
3. Banka është ajo që duhet ta pranojë kthimin e mallit në rast të ndonjë defekti apo mospërputhje me cilësitë e kërkuara nga klienti në kontratë.
4. Çmimi i parë i mallit (kapitali) duhet të jetë i njohur, si dhe çmimi i fitimit të jetë i qartë.
5. Përcaktimi i mënyrës së pagesës në të gatshme, ose me këste, si dhe caktimi i kësteve në formë të saktë, që të mos ketë

hapësirë për paqartësi, të cilat çojnë në konflikt.

6. Sqarimi i procedurës së blerjes për blerësin.

7. Sasia e fitimit, nuk është e caktuar, por i është lënë në kompetencë tregtarëve varësisht nga gjendje të ndryshme të tregtarit apo mallit, sipas traditës tregtare, duke pasur parasysh atë që kërkon etika islame në mëshirë, mosshfrytëzim të rastit, falje dhe lehtësi.

8. Sasia e fitimit mund të përcaktohet si shumë e caktuar, ose në përqindje, p.sh., vetura kushton 25,000€ fitimi është 2,300€, ose vetura kushton 25,000€ ndërsa fitimi 3,7% në vit.

Dallimet në mes murabahas dhe kreditit bankar

1. murabaha është këmbim i produktit me para, kurse krediti është këmbim i parave me para shtesë.

2. Çmimi i afatizuar i murabahas është statik nuk shtohet, kurse krediti shtohet me vonimin e afatit.

3. Bankat konvencionale japin kreditin (para) dhe shpeshherë nuk dihet ku shkojnë ato para, kurse në murabaha bankat islame nuk ia dorëzojnë paratë klientit, por ajo është një ndërmjetës në shitblerje dhe kjo e gjallëron ekonominë dhe e ul mundësinë e inflacionit.

Ata që thonë se murabaha është njësoj si kamata dhe se bankat islame janë si ato konvencionale, kjo thënie nuk është e re, kështu thoshin edhe idhujtarët: shitblerja është njësoj si kamata, por Allahu e ka lejuar shitblerjen dhe e ka ndaluar kamatën. ■

BETEJA E VËRTETË E GRUAS



Në periudhën e paqëndrueshmërisë, rrëmujës dhe importimit të verbër të teorive feministe në vendet tona, roli i gruas në edukimin e fëmijëve të saj u konceptua si një padrejtësi karshi të drejtave të saj, përcëimim për personalitetin e saj dhe nënvleftësim për aftësitë e saj

DR. DEJMA TARIK TAHBUB

Një nga rregullat që përbën idetë moderne në edukimin islam është fjala e Ali ibën Ebu Talibit *radijallahu anhu*: “Mos i mësoni fëmijët sipas traditës tuaj, sepse ata janë krijuar për një kohë ndryshe nga koha juaj.” Pavarësisht koherencës, ecurisë bashkë me shpirtin e kohës, vizionit moderues që gërsheton thelbin e Islamit me avancimin e kohës dhe shmangies nga zakoni, që thotë: “Me këtë mendim i gjetëm baballarët tanë”, përsëri edukatorët e kanë kuptuar dhe praktikuar shtrembër këtë thënie. Për këtë

arsye ne jemi kthyer në baballarë dhe nëna që përpiqemi të sigurojmë të gjitha kushtet e rehatisë, dëfrimit, studimit jashtë, klubeve kulturore dhe të gjitha mjetet e teknologjisë për fëmijët tanë në mënyrë që ata të mos jenë të përjashtuar dhe ndryshe nga fëmijët e tjerë të kohës së tyre. E gjitha kjo kryhet pa e shoqëruar këtë bujari të gjerë për të siguruar mjetet dhe kushtet me një metodologji edukuese, duke shikuar me kujdes përfitimet e pasojat dhe duke menduar se çfarë do të jetë biri dhe bija ime kur të rriten, por kjo e parë në një prizëm që e tejkalon prizmin e baballarëve tanë, të cilët nuk kanë lënë gjë pa shpenzuar për ne, por që kulmi i dëshirave të

“Mos i mësoni fëmijët sipas traditës tuaj, sepse ata janë krijuar për një kohë ndryshe nga koha juaj...”

tyre ishte që fëmijët e tyre të bëheshin mjekë apo inxhinierë.

Ngjarjet dhe kthesat e rrezikshme që po kalon umeti e detyrojnë nënën, që është streha e parë përgjegjëse për edukimin e fëmijëve, që të ndërjegjësohet për edukimin e një brezi, i cili do të mund të bëjë realitet fitoren, ose të shkaktojë humbjen. Ky brez ka nevojë për një brez nënash siç ishte Hansaja, ose të paktën si nëna e Abdullahit të vogël, e cila nuk e kurseu fjalën e vërtetë për të shtuar edhe më shumë gjëmën dhe fajin mbi kokën e djalit të saj pas rënies së Andaluzisë, kur i tha atij: “Qaj si gratë për një mbretëri të humbur, të cilën nuk arrite ta mbroje si burrat.”

E gjendur mes këtyre dy shembujve nëna është e detyruar që të edukojë udhëheqës, ushtarë dhe dijetarë, ose të prishë dhe të prodhojë njerëz që u ngjajnë burrave; burra që lindin dhe vdesin pa shtuar asgjë në vlerat e Umetit, ose që bëhen shkaktarë për dobësimin e tij. Filozofët e Perëndimit e kanë kuptuar rëndësinë e rolit të gruas në edukim dhe njëri prej tyre thotë: “Nëse dëshiron një brez të madh, atëherë duhet të edukosh gruan, sepse ajo i përgatit njerëzit e mëdhenj.”

Poeti Amursen, duke përkufizuar civilizimin thotë: “Civilizimi është pushteti i grave të mira.” E mira në këtë rast nuk nënkupton naivitetin, idiotësinë dhe neglizhencën e gjërave. Pushteti i gruas së mirë do të thotë orientim i përpjekjeve dhe realizimi i shkaqeve me një vizion largpamës për të sjellë dobi dhe mirësi për të tjerët.

Në periudhën e paqëndrueshmërisë, rrëmujës dhe importimit të verbër të teorive feministe në vendet tona, roli i gruas në edukimin e fëmijëve të saj u konceptua si një padrejtësi karshi të drejtave të saj, përçmim për personalitetin e saj dhe nënvleftësim për aftësitë e saj, ndërkohë që Perëndimi u kthye në shumë vende të tij - pasi më parë kishte shijuar hidhësinë e mungesës së edukimit - drejt rritjes së pozitës së mëmësisë dhe funksioneve të saj. Këtë e vëren në programet e tyre publicitare, të cilat e pasqyrojnë nënën si një nga punonjëset e zonja më të mira me një minutazh të vazhdueshëm prej 24 orësh në të shtatë ditët e javës “*A Mother 24/7*”. Këto programe ndjekin njëra tjetrën duke iu kushtuar edukatoreve profesioniste, të cilat i mësojnë nënat sesi të komunikojnë me fëmijët e tyre, sesi të shtojnë aftësitë e tyre, sesi të kontrollojnë zemërimin dhe inatin... etj. Sikur edukimi të mos kishte asnjë rëndësi, këto vende të zhvilluara që bëjnë thirrje për lirinë e mendimit, pjesëmarrjes dhe individualizmit nuk do t'i jepnin shumë rëndësi këtyre shembujve.

Le t'i kthehemi porosisë që i la Hansaja djemve të saj përpara se të dilnin në luftë në betejën e Kadisijes: «Ju u bëtë muslimanë me dëshirën tuaj dhe emigruat me zgjedhjen tuaj. Pasha Allahun, që nuk ka zot tjetër të adhuruar me të drejtë përveç Tij, ju jeni djem të një burri të vetëm dhe djem të një gruaje të vetme. Kurrë nuk e kam tradhtuar babanë tuaj, as nuk e kam fëlliqur dajën tuaj, as nuk e kam përzier origjinën tuaj dhe as nuk e kam përbaltur prejardhjen tuaj. Ju e dini se çfarë shpërblimi të madh ka përgatitur Allahu për muslimanët me luftën e tyre kundër jobesimtarëve. Dije se Vendi i Përhershëm (ahireti) është më i mirë se vendi i përkohshëm (dynjaja). Nëse gdhini nesër, hidhuni për ta luftuar armikun tuaj me largpamësi dhe duke kërkuar ndihmën e

Allahut kundër armiqve të Tij.” Kjo ishte një nënë e pastër në qenien dhe mendimin e saj dhe e ndërgjegjshme për rolin e saj karshi djemve të saj.

Ky mësim i rëndë prej saj dhe kjo përgjigje prej fëmijëve të saj nuk ishin reagime të çastit dhe të situatës, por ishin qëndrime, të cilat nuk mund t'i mbante veçse një nënë, e cila kishte edukuar veten dhe fëmijët e saj me një ambicie të lartë për shumë vite me radhë, derisa ata mbërritën në moshën e pjekurisë; një nënë luftarake dhe djem dëshmorë.

Përndryshe qëndrimi i saj pas rënies së djemve të saj do të kishte qenë një imagjinatë apo një përjashtim i natyrës njerëzore, kur ajo falënderoi Allahun për rënien e tyre dëshmorë. Për këtë ajo dhe fëmijët e saj patën fatin e përkujtimit me mburrje dhe vlerësim me kalimin e ditëve. Cila mund të jetë arsyeja që qëndron pas motrës që qau vëllain e saj Sahrin derisa u vyshk dhe nënës që nuk i doli loti veçse prej dhembshurisë që ka zemra e nënës për fëmijët e saj, përveç arsyes së pjekurisë në besim dhe të vetëdijesimit për përgjegjësitë, të cilat i tejkalojnë ndjenjat e kësaj bote, që ziejnë në gjokset e nënave, siç është dashuria, frika dhe ankthi për fëmijët e tyre? Për këto ndjenja shumë nëna janë të zonjat, por shumë pak prej tyre arrijnë të bëjnë atë që bëri Hansaja. Për këtë arsye është thënë se luftërat dhe fitoret bëhen në zemrat e nënave përpara se të bëhen në frontet e luftës.

Do të donim të edukonim fëmijët tanë për një kohë ndryshe nga koha jonë, por ja që koha e tyre vjen më e zyrtë, më e errët dhe më sfiduese në rrafshin e umetit.

Nëse dëshirojmë që edukimi të ecë njëkohësisht me kohën, atëherë iu del si detyrë nënave dhe baballarëve, që të armatosen me të kuptuarin e mesazhit të edukimit, duke vendosur gjithmonë pas bujarisë dhe privimit një objektivi që e

“Plagët e të tjerëve nuk mjekohen vetëm duke hapur xhepin, por kanë nevojë për hapjen e zemrës...”

kuptojnë fëmijët, duke vendosur pas arsimimit dhe rritjes së aftësive angazhimin për të arritur një qëllim të lartë. Mirësia e ekzistencës pranë një familjeje bën të nevojshme ndjesinë për një familje të madhe anëtarët e të cilës kanë humbur nënat, baballarët dhe vëllezërit e tyre, ku përkujdesja ndaj tyre kthehet në një detyrë shpirtërore dhe sociale dhe jo vetëm përkujdesje materiale. Plagët e të tjerëve nuk mjekohen vetëm duke hapur xhepin, por kanë nevojë për hapjen e zemrës. I Dërguari i Allahut ka thënë të vërtetën kur thotë: *“Ju nuk do të mund t'i bëni njerëzit për vete me pasurinë tuaj, por ajo që i bën ata për vete është buzëqeshja e fytyrës dhe sjellja e mirë.”* Këtë botëkuptim familjar gjithëpërfshirës, këtë shoqëri dhe umet dashamirës, këtë bashkim dhe lidhje nuk mund ta mbjellë në familje dikush tjetër përveç nënës.

Popujt dhe civilizimet para nesh arritën të kuptonin rolin e grave në krijimin e fitores. Imam Asfahani përshkruan rolin e grave frënge në krijimin e fitores, kur thotë: *“Në mesin e frëngjve ka gra kalorëse që mbartin mburoja dhe harqe. Ato dallohen kur beteja arrin kulmin dhe tregojnë kurajë. Të gjitha këto, ato i besojnë si adhurim dhe i bëjnë si adhurim.”*

Beteja e vërtetë e gruas është edukimi i brezit të ri. Nëse gruaja do të tregojë pjesët e saj të dobëta, dobësia do të arrijë të depërtojë dhe armiqtë do t'i hyjnë këtij umeti përmes gruas. ■

FLIRTI DHE TRADHTIA BASHKËSHORTORE (4/4)

UDHËZIME PËR ATA QË DUAN TË SHËROJNË TRADHTINË BASHKËSHORTORE

Nga përvoja ime në fushën e Këshillimit Familjar, në shumicën e rasteve kam parë se gruaja është ajo që vuan nga tradhtia e burrit dhe vetëm ajo ankohet, ndërsa shumë të rralla janë rastet kur burrat kërkojnë shërimin e devijimeve të gruas, sepse me të shpejtë e shërojnë atë devijim me armën e të paaftit: divorcin.

DR. IBRAHIM NUKAJTHAN

Në numrat e kaluar e shpjeguar këtë problem duke paraqitur faktorët që ndikojnë në shfaqjen e tij, përmendëm ca dukuri dhe pasoja të këtij problemi e po ashtu sollëm disa shembuj të vërtetë nga familje që u dogjën nga zjarri i flirtit dhe i tradhtisë. Punimin do ta përmbyllim në këtë numër, ku do të përmendim udhëzime drejtuar atyre që marrin përsipër t'i shërojnë dhe t'i rehabilitojnë ata që pësuan nga këto gjynahe.

Këshilla drejtuar atyre që duan të shërojnë këto raste:

Tradhtia është një çështje që gjendet në shoqëritë muslimane dhe këtë nuk mund ta mohojë asnjë i drejtë, megjithëse në



vendlindjen time - elhamdulillah - nuk është një dukuri aq e përhapur shoqërore. Ata që marrin përsipër të shërojnë probleme familjare duhet të marrin parasysh edhe raste të këtilla, pastaj të përpiqen me të gjitha mundësitë, që t'i zgjidhin këto probleme duke e shpresuar shpërblimin e madh dhe mirësitë e shumta, që Allahu jep kundrejt bamirësisë, ndihmës ndaj nevojtarit dhe zgjidhjes së brengave:

- T'i kuptojë përmasat e këtyre problemeve bashkëshortore.

- T'i përmbahet kodit të sjelljes islame në diskutimet, stilin dhe sugjerimet e tij.

- Të ketë bindjen se çdo problem ka zgjidhje, pavarësisht e arrin atë apo ai personalisht nuk ka mundësi ta arrijë.

- Dhënia e ndihmës dhe përkrahjes ndaj atij apo asaj që kërkon këshilla dhe udhëzime.

- Të tentojë të njohë shkaqet reale të problemit dhe jo t'i adresojë të gjitha vetëm në adresë të burrit.

- Ka mundësi që ky problem të jetë thjesht një rezultat i ndonjë problemi më të madh dhe më të thellë nga jeta bashkëshortore, ndaj ai që dëshiron të japë këshilla duhet ta vërtetojë këtë.

- Të tentojë të parashtojë shkaqe të tjera hipotetike, të cilat ndoshta qëndrojnë pas këtij problemi, ndërsa ata mundohen t'i injorojnë ato ose me të vërtetë nuk i njohin.

- Të nënvlerësojë problemin para palëve, duke e krahasuar problemin e tyre me probleme më të mëdha dhe më të rrezikshme.

- Të ofrojë disa zëvendësime për të tejkaluar problemin pasi t'i njohë shkaqet reale të problemit.

- Të përhapë shpresën te burri dhe te gruaja dhe të instalojë tek ata moralin e

“Njohja e gjërave që tërheqin zemrën e burrit, që pastaj t'i mësojë dhe t'i kultivojë ato, pavarësisht nëse ka të bëjë me shtëpinë, veshjen e saj, makijazhin, rregullimin e flokëve...”

durimit, duke u shpjeguar për vlerën që durimi ka tek Allahu.

- Ta thërrasë burrin dhe gruan të shfrytëzojnë praninë e fëmijëve mes tyre, duke i frikësuar për rrezikun e nderit dhe shkëputjen e kënaqësisë së shpirtit.

Ilaçi:

Disa burra apo gra nëse i shohin apo u flitet atyre për dëmet dhe pasojat që i shkakton tradhtia, për të cilat atyre nuk u ka shkuar mendja, kjo mund të ndikojë që të heqin dorë nga ky ves i ndaluar. Mirëpo forma sesi t'ia themi këto tradhtarit apo flirtuesit dallon nga individi dhe personaliteti i njeriut, kështu që mund të propozojmë metoda të tjera që mund të përshtaten me rastin. Prej atyre metodave janë:

1. Sigurimi se tradhtia ka ndodhur me të vërtetë dhe jo duke u mbështetur në supozime apo hamendje.

2. Të tentojë ndërlihdjen e bërjes së gjynaheve, duke e frikësuar keqbërësin me përfundimin e keq.

3. Përkujtimi i burrit apo gruas që ka rënë në sprovën e tradhtisë, se në sprova ka urtësi të mëdha, ndonjëherë ka shumë mirësi, mirëpo për këtë duhet të luftojë duke bërë lutje, namaze vullnetare dhe duke dhënë sadaka.

4. Pendimi, nga të dy palët apo së paku për atë i cili ankohet, sepse kjo sjell rehabilitimin shpirtëror, i cili është shumë i rëndësishëm.

5. Njohja e personalitetit të tradhtarit për të qenë kjo një hyrje për shërimin dhe përmirësimin e tij.

Nga përvoja ime në fushën e Këshillimit Familjar, në shumicën e rasteve kam parë se gruaja është ajo që vuan nga tradhtia e burrit dhe vetëm ajo ankohet, ndërsa shumë të rralla janë rastet kur burrat kërkojnë shërimin e devijimeve të gruas, sepse me të shpejtë e shërojnë atë devijim me armën e të paafittit: divorcin.

Nga ilaçet që mund të bëjnë dobi – me lejen e Allahut – janë këto:

- Gruaja në kësi problemesh duhet të përmbahet me urtësi dhe jo ta kaplojë emocionin, xhelozia dhe goditja, sepse kjo do ta bëjë që gabimin ta kthejë me gabim, duke shpërfillur kujdesin ndaj shtëpisë apo së paku ndaj burrit. Në fillim ajo nuk duhet të tregojë shenja pakënaqësie, sidomos nëse burri është shpërfillës apo i disponuar kundër saj.

- Të sigurohet plotësisht për tradhtinë dhe të gjejë argumentin e prerë, se burri i saj me të vërtetë e ka kryer tradhtinë, e gjithë kjo para se të marrë ndonjë nismë tjetër.

- Njohja e gjërave që tërheqin zemrën e burrit, që pastaj t'i mësojë dhe t'i kultivojë ato, pavarësisht nëse ka të bëjë me shtëpinë, veshjen e saj, makijazhin, rregullimin e flokëve, mobilet e shtëpisë, dhomën e gjumit, ndriçimin, ngjyrat, rrobat e brendshme, lëvizjet gjatë seksit etj.

- Të nxitojë drejt risive dhe përparimit në mënyrën e sjelljes së saj, kur e pret burrin në shtëpi apo e përcjell, si dhe gjëra të tjera të ngjashme.

- Të hulumtojë gjetjen e materialeve që shërojnë problemin e tradhtisë, t'i tubojë ato, t'i radhisë dhe pastaj të zgjedhë ndonjë metodë të përshtatshme për t'ia parashtruar, sikurse:

- dorëzimi i atij materiali në formë të shkruar, duke e shoqëruar me fjalë të bukura dhe të buta.

- shprehja e atij materiali gojarisht, me metodën e të dashurit që ka dhembshuri.

- printimi i atij materiali dhe vendosja diku ku mund ta shohë ai, në tavolinë, sallon apo dhomën e gjumit.

- vendosja e atij materiali në kompjuter apo aparatit e DVD-së, nëse materiali është video, për ta shikuar atë në një moment të përshtatshëm për të dy.

- nëse materiali është audio, atëherë t'ia bëjë të dëgjueshme nga magnetofoni, si p.sh. ta vendosë kasetën apo CD-në në magnetofon dhe kur të shohë rastin se mund ta dëgjojë edhe burri, ajo shkon dhe e lëshon kasetën sikur ajo dëshiron ta dëgjojë për vete.

- dërgimi i disa pjesëve nga materiali me sms herë pas here, duke i shoqëruar me fjalë të ëmbla, këshilluese, ndikuese dhe të shkurtra.

- vendosja e atij materiali në desktop të kompjuterit pasi materiali të jetë i gatshëm për ta shikuar (në flash, video, film me ilustrime, karikaturë), dëgjuar apo lexuar (në word, powerpoint).

- nëse materiali është i regjistruar në audio, atëherë le të mundohet t'ia sjellë situatën që burri ta dëgjojë në veturë. P.sh., nëse janë duke bërë ndonjë udhëtim të gjatë, ajo i kërkon leje që ta vendosë atë kasetë (CD apo USB) në radion e veturës duke u arsyetuar se herët e tjera, nuk ka mundur ta dëgjojë për shkak të udhëtimeve të shkurtra, por në realitet arsyeja kryesore është që burri ta dëgjojë

atë material. Madje për ta bindur edhe më shumë, se vetë ajo dëshiron të përfitojë nga ai material, preferohet të nxjerrë një laps e një letër dhe të regjistrojë pikat më të rëndësishme që i thotë ligjëruesi... e kështu me radhë.

- Nëse këto metoda nuk kanë sukses, atëherë mund të telefonojë në subjekte që merren me Këshillime Familjare, që gjenden nëpër disa shtete.

- Nëse edhe kjo nuk ka sukses, ose nuk mund të gjejë asi subjektësh, atëherë le të hulumtojë të gjejë ndonjë njeri të mençur dhe të urtë, qoftë ai mashkull apo femër nga familja e saj dhe bashkërisht të parashtrajnë problemin dhe të kërkojnë zgjidhjen më të mirë.

Në fund, e lusim Allahun e Madhërisëm të na i rregullojë njetet dhe veprat tona. Ai është më i Miri nga kush mund të kërkojmë. Ai është pa të meta. Lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi krijesën më të mirë, mbi familjen e tij, shokët e tij dhe ndjekësit e tij deri në Ditën e Gjykimit. ■

Nga arabishtja: Omer B.

T'I MËSOJMË FËMIJËT E VEGJËL PËR VLERËN E PRIVATËSISË

Është e rëndësishme që t'u mësojmë fëmijëve për vlerën e jetës private në një moshë të re. Ata duhet të bëhen të vetëdijshëm se disa gjëra janë private dhe duhet të mbahen sekret

HANAN ZAIN

Fëmijët e vegjël janë të pafajshëm. Si pasojë, ata nuk janë në gjendje të dallojnë informacione të ndryshme që ata marrin - se çka është e drejtë për të bërë publike dhe çfarë duhet të mbahet private.

Në rrjedhën e zhvillimit të tyre ata mësojnë lirinë e veprimit, por gjersa ta arrijnë, pafajësia e tyre e këndshme mund të shkaktojë shumë vështirësi dhe siklet për prindërit e tyre. Kjo për shkak se ata lehtë mund të flasin jashtë me të tjerët për çështje familjare që janë



delikate dhe private.

Është e rëndësishme që t'u mësojmë fëmijëve për vlerën e jetës private në një moshë të re. Ata duhet të bëhen të vetëdijshëm se disa gjëra janë private dhe duhet të mbahen sekret. Prindërit duhet të jenë vigjilentë dhe t'i mësojnë ata për t'i mbajtur disa gjëra private. Të rriturit nuk duhet t'i diskutojnë disa gjëra para fëmijëve të tyre, veçanërisht problemet që mund të kenë nëna dhe babai.

Edhe duke biseduar në telefon para fëmijëve duhet të kemi kujdes, kur çështja

“Në një moshë shumë të re, fëmijët e vegjël janë thjesht të paaftë të dallojnë midis asaj që është private dhe çfarë nuk është...” ”

është një çështje private familjare, e cila nuk duhet të bëhet e njohur për publikun e gjerë. Në një moshë shumë të re, fëmijët e vegjël janë thjesht të paaftë të dallojnë midis asaj që është private dhe çfarë nuk është.

Kur fëmija fillon të rritet, një respekt për jetën private duhet të jetë i rrënjosur tek ata. Duhet të kuptojnë konceptin e shtëpisë si një sferë private. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, kur fëmijët fillojnë të shkojnë në shkollë. Por si mund të arrihet kjo?

Fëmijët janë të hapur për krahasime vizuale. Për shembull: “Kjo shtëpi që jetojmë na ruan (strehon) nga bota e jashtme. A do të jemi në gjendje të ulemi në të sikur të mos ketë mure? A do të jemi në gjendje për t’u ulur në tryezë dhe të hamë darkën tonë me secilin që na shikon nga jashtë?”

Në këtë mënyrë, ne mund t’ua prezantojmë (fusim) konceptin e intimitetit në mendjet e tyre dhe t’i inkurajojmë fëmijët tanë të identifikohen me shtëpinë dhe familjen e tyre. Nga kjo pikënisje mund t’i mësojmë fëmijëve në lidhje me nevojën për të mbajtur fort familjen dhe çështjet personale si sekret nga publiku i përgjithshëm. Faza tjetër është të ndihmohet fëmija, që të zhvillojë një kuptim të plotë të intimitetit dhe dimensionet e tij praktike. Kjo fillon duke e mësuar fëmijën për të kërkuar leje para se të hyjë në ndonjë dhomë.

Allahu na urdhëron në Kuran, që t’ia mësojmë këtë porosi fëmijëve tanë: **“O ju që besuat, ata që i keni në pronësinë tuaj (shërbëtorët) dhe ata që nuk kanë arritur moshën e pjekurisë duhet të kërkojnë leje prej jush (për të hyrë te ju) në tri kohë: para namazit të sabahut, në kohën e drekës kur i hiqni rrobat tuaja (për të pushuar) dhe pas namazit të jacisë, që të tria këto kohë janë kur ju nuk jeni të veshur. Pos atyre tri kohëve nuk është mëkat, as për ju, as për ata të vizitoni njëri-tjetrin. Kështu Allahu ua sqaron**

“...Të rriturit nuk duhet t’i diskutojnë disa gjëra para fëmijëve të tyre, veçanërisht problemet që mund të kenë nëna dhe babai....”

argumentet e veta. Allahu është i dijsلمي, i urti.” Nur: 58.

Në këtë ajet, Allahu na urdhëron, që t’i mësojnë fëmijët tanë, të cilët nuk e kanë arritur moshën e pjekurisë për të kërkuar leje para se të hyjnë në ndonjë dhomë në tre kohë të ditës. E para, është para faljes së sabahut, kur njerëzit janë në gjumë zakonisht në shtretërit e tyre. E dyta, është në mesditë, ku në shumë kultura njerëzit flenë gjumë pasdreke dhe mund të jenë në dhomat e tyre duke pushuar të zhveshur. Dhe e treta, është gjatë natës, gjithashtu një kohë pushimi dhe gjumi. Këto janë tre kohë, kur një fëmijë mund të eci nëpër dhomat e gjumit të prindërve dhe t’i gjejë prindërit në një situatë të papërshtatshme.

Për shkak të nevojave të fëmijëve të vegjël Kurani i urdhëron vetëm prindërit, që t’i mësojnë ata për të kërkuar leje në këto tre kohë. Kur të rriten duhet të ndjekin mësimet e Islamit për të kërkuar leje në çdo kohë para se të hyjnë në ndonjë dhomë private.

“E kur fëmijët tuaj ta arrijnë moshën e pjekurisë, le të kërkojnë leje (për hyrje), ashtu si kërkuan ata para tyre. Allahu ju shpjegon dispozitat e veta, sepse Ai e di më së miri dhe është më i urti.” Nur: 59. ■

nga anglishtja: Fitim NUHIU

EUFORIA PËR PUNË MËKATI

“Ka ndonjë nga njerëzit që fjala e tij të mahnit, por vetëm në këtë botë (meqë në botën tjetër gjykon Ai që i di të fshehtat), dhe për atë që ka në zemrën e tij, e paraqet Allahun dëshmues, e në realitet ai është kundërshtari më i rreptë. E posa të kthehet ai në tokë kryen shkatërrime në te, asgjëson të korrrat (mbjellat) dhe gjallesat. E Allahu nuk e do çrregullimin (fesadin). Dhe kur i thuhet atij: “Ki frikë Allahun”!, atë e kap eufori për punë mëkati. Shtrat i shëmtuar është ai që i takon atij (xhehenemi).” Bekare, 204-206.

SHKRUAN: ALI SHABANI

Kurtubiu dhe Sheukani në komentet e tyre thonë, se Allahu i Madhëruar i ka përmendur besimtarët që kërkojnë

prej Allahut të mirat e dy botëve, por nuk lakmojnë në dynja: *“E, ka prej tyre asish që thonë: “Zoti ynë na jep të mira në këtë jetë, të mira edhe në botën tjetër dhe na ruaj prej dënimit me zjarr.”* Bekare 201, pastaj ka përmendur mynafikët, të cilët

shfaqnin Islamin, por fshihnin kufrin. Ibën Kethiri përmend nga Ibën Abasi, se këto ajete kanë zbritur në lidhje me një grup mynafikësh, të cilët folën kundër Hubejbit dhe shokëve të tij, që ranë dëshmorë në Rexhia.

Kurtubiu përmend se Sudi dhe mufesirë të tjerë thonë se ka zbritur në lidhje me Ahnes ibën Sherikun, i cili thirrej Ubej. Ahnes (i zmbraur) ishte një llagap që e kishte marrë në ditën e Bedrit, kur u zmbraur me treqind veta nga paria e tij nga Beni Zehra. Ai kishte një pamje dhe të folur të ëmbël. Ai pastaj kishte shkuar para Pejgamberit *sal-Allahu alejhi ue selem* dhe e shfaqti Islamin. Tha: Allahu e di se unë jam besnik. Pastaj ka ikur dhe kur ka kaluar nga arat e disa muslimanëve ua ka djegur dhe i ka dëbuar gomarët e i ka mbytur. Mehdiu thotë se në lidhje me këtë ka zbritur edhe **“Mos e respekto askënd që betohet shumë dhe është i poshtër! Që është përgojues e mban fjalën ndër njerëz.”** Kalem 10, 11; dhe **“Mjerë për këdo që ofendon e përqesh (njerëzit).”** Humeze 1.

Ibën Xheriri përcjell nga Neufi, i cili i kishte lexuar Librat dhe ai ka thënë: Unë i has cilësitë e njerëzve në librin e shpallur të Allahut: **Njerëz që vazhdojnë të përfitojnë nga kjo dynja duke e keqpërdorur fenë, gjuhët i kanë më të ëmbla se mjalti, ndërsa zemrat i kanë më të hidhura se bima e hidhët, para njerëzve vishen me lëkurë deleje, ndërsa zemrat i kanë si zemrat e ujqve. Allahu i Madhëruar ka thënë: Ata ndaj Meje kanë guxim të mëkatojnë dhe me emrin Tim mashtrojnë. Jam betuar në Vetën Time, se do t'ua çoj një sprovë, saqë edhe i buti do**

“Njerëz që vazhdojnë të përfitojnë nga kjo dynja duke e keqpërdorur fenë, gjuhët i kanë më të ëmbla se mjalti, ndërsa zemrat i kanë më të hidhura se bima e hidhët, para njerëzve vishen me lëkurë deleje, ndërsa zemrat i kanë si zemrat e ujqve...”

të mbetet i hutuar. Hadith kudsii.

Kuredhiu ka thënë: Kam gjurmuar rreth atyre në ajetet kuranore dhe i kam gjetur se janë përshkrim i munafikëve: **“Ka ndonjë nga njerëzit që fjala e tij të mahnit, por vetëm në këtë botë dhe për atë që ka në zemrën e tij, e paraqet Allahun dëshmues, e në realitet ai është kundërshtari më i rreptë.”**

Ibën Muhajsin ajetin e ka lexuar me kiraetin tjetër d.m.th.: **“...Allahu është dëshmues i asaj që ai fsheh në zemër.”**, siç është në ajetin: **“Kur të erdhën ty hipokritët, të thanë: “Ne dëshmojmë se vërtet ti je i Dërguari i Allahut!” E, Allahu e di se ti je i dërguar i Tij, por Allahu dëshmon se hipokritët janë rrenacakë (kur thonë ashtu).”** Munafikun 1. Xhumhuri e ka lexuar me kiraetin **“...e paraqet Allahun dëshmues...”** siç është ajeti **“Ata fshihen (turpërohen) prej njerëzve, e nuk turpërohen prej**

Allahut...” Nisa 108.

Nifaku (dyfytyrësia) është gjë e fshehtë dhe vërtetësinë e tij e di vetëm Allahu. Ne nuk mundemi ta dimë, se njeriu çfarë fsheh në zemrën e tij, prandaj ne duhet të gjykojmë nga ana e jashtme, siç ka thënë Omer ibën Hatabi në hadithin, që e përcjell Buhariu: “O ju njerëz, **vahji** (shpallja) është ndërprerë, e tani ju gjykojmë sipas asaj që shohim nga veprat tuaja. Kush prej jush shfaq prej jush vepra të mira, e sigurojmë dhe e afrojmë, ndërsa neve nuk ngarkohemi për fshehtësitë e tij. Allahu e gjykon për fshehtësitë e tij. Kush shfaq vepra të këqija, nuk e sigurojmë dhe nuk i besojmë edhe nëse thotë se anën e fshehtë e ka të mirë.

Thënia e Allahut të Madhëruar: **“...ai është kundërshtari më i rreptë.”**, d.m.th i padrejtë, se ai në rast polemike kërkon me të gjitha mënyrat të mundë palën tjetër. Muslimi përcjell nga Aishja, *radijallahu anha*, se Pejgamberi, *sal-lAllahu alejhi ue selem* ka thënë: “Njeriu më i urryer tek Allahu është kundërshtari i rreptë (i padrejtë).”

Ibën Kethiri në komentin e tij ka thënë: **“...ai është kundërshtari më i rreptë”**, se ai (munafiku) në rast zënke, gënjen, shtrembëron të vërtetën, mashtron, shpif dhe sillet padrejtësisht. Kështu qëndron në hadithin, që e transmeton Buhariu nga Aishja, se Pejgamberi *sal-lAllahu alejhi ue selem* ka thënë: “Shenjat e munafikut janë tre: Kur flet gënjen, kur besatohet e thyen besën dhe kur është në zënkë sillet padrejtësisht.”

Thënia e Allahut të Madhëruar: **“E posa**

**“...Allahu e përmend
nxitimimin e munafikut, se ai
pas hipokrizisë që ka, sillet
keq me të tjerët, nuk i
mjafton vetëm aq...”**”

të kthehet ai në tokë, nxiton të bëjë shkatërrim në të, të asgjësojë të korrat (mbjelljet) **dhe gjallesat. E Allahu nuk e do çrregullimin** (fesadin).”, d.m.th se munafikët janë edhe fjalëkëqij dhe vepërkëqij. Fjala “nxitim”- “s’aj” ka ardhur me kuptim pozitiv dhe negativ, se njeriu nxiton për punë të mira, por fatkeqësisht ka sish që nxitojnë për punë të këqija, Allahu na ruajt. Nxitimimin fizik, Pejgamberi *sal-lAllahu alejhi ue selem* e ka ndaluar. Ai ka thënë: “Kur të shkoni për ta falur namazin, mos shkoni duke nxituar, por ecni me maturi dhe ngadalë e qetë...”. Në ajetin kuranor Allahu e përmend nxitimimin e munafikut, se ai pas hipokrizisë që ka, sillet keq me të tjerët, nuk i mjafton vetëm aq, por **“nxiton të bëjë shkatërrim në të, të asgjësojë të korrat** (mbjelljet) **dhe gjallesat”**. Nifaku shkakton shumë gjëra të këqija. Përçarjen mes muslimanëve, shkatërrimin e bereqeteve, çrregullimet familjare, shumë përleshje dhe luftëra. Tirmidhiu përcjell se Pejgamberi *sal-lAllahu alejhi ue selem* ka thënë: “Kur ta shohin zullumqarin dhe nuk e ndalin nga zullumi, së shpejti Allahu do t’i përfshijë me dënim prej Tij.”

Thënia e Allahut të Madhëruar: **“...E Allahu nuk e do çrregullimin** (fesadin).”, i

“Mjafton mëkati për njeriun, kur vëllau i vet i thotë: Ki frikë Allahun! Ai ia kthen: Shikoje veten tënde, një si ti më këshillon?!...”

përfshin të gjitha çrregullimet: në tokë, pasuri, në familje, në fe. Ibën Xheriri dhe Ebu Hatimi përmendin, se është pyetur Muxhahidi për ajetin kuranor **“E posa të kthehet ai në tokë, nxiton të bëjë shkatërrim në të...”** ka thënë: “Ai jeton në tokë, por bën armiqësi, zullum, e Allahu si ndëshkim e ndal shiun nga qielli dhe kështu shkatërrohen bereqetet, krijesat edhe pse **“Allahu nuk e do çrregullimin (fesadin)”**.”

Pastaj Muxhahidi ka lexuar ajetin: **“Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të asaj të keqeje që bënë...”** Rum 41.

Munafikët janë shumë problematikë, sepse ata nuk e përfillin këshillën dhe bëjnë mendjemadhësi. Allahu i Madhëruar pasi i qartëson qëndrimet dhe veprat e tyre, na tregon edhe mendjemadhësinë e tyre. Ai ka thënë: **“Dhe kur i thuhet atij: “Ki frikë Allahun!”, atë e kap eufori për punë mëkati. Shtrat i shëmtuar është ai që i takon atij (xhehenemi)”**. Ibën Kethiri në tefsirin e tij ka thënë, se munafiku kur e këshillojnë dhe i thuhet që të shmangët nga ato vepra të këqija, nuk pranon, nevríkuset, nxehet me mëkatet që ai i ka në brendësi.

Kurtubiu përmend fjalën e Abdullah ibën Mesudit *radijallahu anhu*, se ka thënë: “Mjafton mëkati për njeriun, kur vëllau i vet i thotë: Ki frikë Allahun! Ai ia kthen: Shikoje veten tënde, një si ti më këshillon?!” Taberani dhe Bejhekiu.

Thuhet se një çifut ka pasur nevojë për Harun Rashidin. Ai për një kohë të gjatë ka shkuar shpesh te porta e pallatit, por nuk ia kanë plotësuar nevojën. Një ditë qëndroi afër portës dhe kur doli Harun Rashidi çifuti nxitoi dhe i doli përpara. I tha: Ki frikë Allahun, o prijës i besimtarëve! Haruni zbret nga kafsha dhe përkulet duke bërë sexhde (para Allahut). Pasi e ngre kokën, urdhëron që t’ia plotësojnë nevojën, dhe menjëherë e kryen urdhërin. Kur kthehet e pyesin: O prijës i besimtarëve, zbritë nga kafsha për një fjalë të një çifuti?! Tha: Jo, por përkujtova fjalën e Allahut të Madhëruar: **“Dhe kur i thuhet atij: “Ki frikë Allahun!”, atë e kap eufori për punë mëkati.”**

Në fund të ajetit Allahu i Madhëruar paralajmëron dënimin e kësaj shtrese të rrezikshme për shoqërinë dhe thotë: **“... të mjaftueshëm (për ndëshkim) e ka xhehenemin dhe sa vend i keq është ai.”**

E lusim Allahun Fuqiplotë, që të na ruajë nga mëkati, dyfytyrësia dhe të na bëjë besimtarë të singertë, të na mbrojë nga xhehenemi dhe të na bëjë banorë të xhenetit. ■

DO TË ARRIJË ATY KU FUTET DRITA DHE TERRI

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Zinxhiri i hadithit.

Këtë hadith e transmeton Temim Dariu, i cili njihet në histori, si personi nga i cili vetë Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, pat transmetuar një hadith. Bëhet fjalë

Nga Temim Dariu na përcillet të ketë thënë: E kam dëgjuar Profetin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, të thoshte:

“Kjo fe do të arrijë atje ku arrin dita dhe nata. Allahu nuk do të lërë shtëpi lloçi e as leshi veçse do ta fusë në të këtë fe, me krenarinë e krenarit apo me nënçmimin e të nënçmuarit. Krenari kjo me të cilën e krenon Islamin dhe nënçmim me të cilin e nënçmon kufrin”.

për tregimin e Dexhallit, të cilin e kishte takuar Temimi në një ishull të panjohur, atëherë kur ky i fundit kishte humbur dhe ishte akoma i krishterë e me të takuar me Dexhallin pasi bisedoi me të shkoi te Profeti dhe e pranoi Islamit dhe i tregoi për historinë e tij, histori kjo të cilën Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, pastaj e përmendte nëpër raste të ndryshme. Ndërsa hadithin e shënojnë në librat e tyre imam Bejhekiu në Sunen Kubra 9/181, Taberani në Muxhem kebir, 16989, 18042, Ibën Hibani nr. 1631, 1632, Ebu Arube në: El-Munteka minet-tabekat, 1/10/2, Tahavi në Mushkilul Athar, 13/389, nr. 5387. Hadithin e saktëson shejh Albani në Tahdhir Saxhid, fq. 121 dhe rreth tij flet edhe në Silsile Sahiha, hadithi nr. 3.

Rëndësia e hadithit:

Hadithi i lartpërmendur konsiderohet ndër hadithet më shpresëdhënës për umetin islam sidomos në kohët e vështira, kur armiqtë me çdo gjë e sulmojnë këtë fe duke shpifur ndaj saj dhe duke i luftuar muslimanët; gjëra këto përmes të cilave synohet shfarosja e muslimanëve dhe vdekja e këtij dini. Mirëpo shpresat e besimtarëve kurrsesi nuk duhet të lidhen vetëm me përgëzime të tilla profetike e duke vazhduar t'i lexojnë besimtarët hadithet e tilla, ndërsa nga ana tjetër nuk i ndër marrin shkaqet e fitores dhe të përhapjes së fesë së tyre. Shejh Albani, Allahu e mëshiroftë, pas cekjes së këtij hadithi thotë se për të arritur deri tek realizimi i kësaj myzhdeje profetike besimtarët duhet të kenë parimisht parasysh dy kushte: 1) kthimin tek udhëzimi profetik, duke pasuar fenë e pastër, ashtu siç na e ka mësuar Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe (2) përgatitja me forcë dhe me çdo gjë të

mundshme për t'i bërë ballë ushtrive të armikut.

Komenti i hadithit:

“Kjo fe do të arrijë atje ku arrin dita dhe nata”

Në këtë pjesë përmendet dita dhe nata, ku përmes kësaj shprehje synohet i tërë globi pasi drita dhe terri arrijnë në të gjitha vendet e botës pa marrë parasysh ku janë ato. Dita dhe nata këtu përmenden si sinonime të dritës dhe territ, të cilat janë të kundërtat e njëra-tjetrës, gjithashtu janë dy elemente, të cilat nuk kanë të tretë në mes. Prandaj ky realitet na jep të kuptojmë, se përderisa diku ekzistojnë drita ose terri, atëherë aty, ose është e pranishme feja Islame, ose do të jetë në të ardhmen. Përmendja e dritës dhe e territ është shumë më domethënëse, se fenomenet e tjera natyrore, ku me to kuptohet çdo vend në glob, siç edhe e cekëm më lart, gjë e cila nuk është e pranishme tek fenomenet e tjera natyrore, p.sh. vera dhe dimri, i ftohti dhe i nxehti, shiu dhe bora etj., ku të gjitha këto nuk janë të domosdoshme të jenë të pranishme në të gjithë globin, edhe pse secila prej tyre është nga gjërat që nuk kanë të tretë. Kjo për vetë faktin se në disa vende gjithmonë është ngrohtë, ndërsa e kundërta është në vendet e tjera; apo ka vende të cilat gjithmonë janë me klimë mesatare. Kështu sikur të përmendej diçka tjetër përveç dritës së ditës dhe territ të natës do të kishte opsione për dyshim apo debate, ndërsa në rastin në fjalë gjëra të tilla janë absolutisht të eliminuara.

“Allahu nuk do të lërë shtëpi lloçi e as leshi veçse do ta fusë në të këtë fe”

Me fjalën shtëpi lloçi dhe leshi nuk kihet si qëllim vetëm këto dy lloje shtëpish, por nga kjo fjali kuptohet se Profeti kishte si qëllim vetëm marrjen e shembullit të të

“Lloji i dytë i njerëzve përmes të cilëve do të përhapet feja janë qafirët...”

gjitha llojeve të shtëpive, ngaqë në atë kohë zakonisht ekzistonin vetëm këto dy lloj shtëpish. Nga kjo fjali kuptohet se Islami do të hyjë në çdo shtëpi pa marrë parasysh, a është shtëpi e pasur apo e varfër. Në hadith shtëpia e ndërtuar prej lloçi nënkupton shtëpitë e pasanikëve, kurse prej leshi ato të fukarenjve.

Futja e fesë nëpër këto shtëpi nënkupton pranimin e Islamit nga banorët e këtyre shtëpive e jo siç mund të mendojë dikush se me të është si qëllim që Islami hyn në këto shtëpi vetëm përmes librave, televizionit apo së fundmi edhe internetit, duke mos pasur si qëllim pranimin e tyre nga njerëzit. Të dëgjuarit për Islamit apo të lexuarit rreth tij, duke mos e pranuar fenë kjo nuk do të ishte përgëzim nga Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, përkundrazi ky hadith është prej përgëzimeve më të mëdha që flet për përhapjen masive të Islamit, prandaj me të kuptohet përqafimi i fesë. Fjala “Fe” në hadith përmendet e shquar, ku disa shpjegues të njohur aludojnë në faktin, se njerëzit do ta pranojnë fenë e pastër, ashtu siç ka qenë e njohur në kohën e profetit, pasi Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kur e përmendi kishte si qëllim fenë e kohës së tij ashtu e pastër pa bidate e as besëtytni, të cilat janë paraqitur pas gjeneratave të pastra.

“me krenarinë e krenarit apo me nënçmimin e të nënçmuarit”

Kjo do të thotë se Islami do të përhapet përmes dy lloj njerëzish: besimtarëve dhe jobesimtarëve. Të parët do ta përhapin

këtë fe dhe si shkak i kësaj përhapje apo këtij daveti Allahu do t'i bëjë krenarë këta besimtarë. Kjo për hir të misionit të tyre që kanë marrë mbi supe. Kurse lloji i dytë i njerëzve përmes të cilëve do të përhapet feja janë qafirët, të cilët jo se duan ta bëjnë diçka të tillë, por pasi kufri është nënçmimi më i madh i mundshëm, atëherë Allahu i Lartësuar do t'i nënçmojë njerëzit e tillë dhe si shkak i këtij nënçmimi Islami do të përhapet dhe njerëzit qafirë të cilët janë pengesë për përhapjen e fesë do të nënçmohen dhe kështu do të largohet pengesa e përhapjes së fesë.

“Krenari kjo me të cilën e bën krenar Islamit dhe nënçmimi me të cilin e nënçmon kufirin”

Në disa transmetime ceket edhe shtojca: *“Krenari kjo me të cilën e bën krenar Islamit dhe pasuesit e tij dhe nënçmimi me të cilin e nënçmon kufirin dhe pasuesit e tij”*. Kjo do të thotë, se përveçse Islami është krenar, por të tillë do të jenë edhe pasuesit e tij dhe e kundërta kufri do të jetë i nënçmuar mu ashtu siç do të jenë edhe pasuesit e tij, pa marrë parasysh rrethanat dhe kushtet, të cilat duan t'i krijojnë qafirët në favor të tyre, ku përmes tyre mundohen që ta mbajnë situatën në favor dhe në kontroll të tyre, kurse në disfavor të muslimanëve. Qafirët përmes kësaj strategjie dhe duke u bazuar në filozofinë e tyre mundohen t'i nënçmojnë besimtarët me të gjitha format: duke i quajtur terroristë pasuesit e fesë, vehabi pasuesit e Sunetit (ku në fakt nuk dinë çfarë do të thotë ky term), i ndalojnë vajzat t'i mbajnë shamitë, bile edhe në vendet Islame. Sipas tyre çdo iniciativë islame është e rrezikshme, çdo problem i shkaktuar nga një individ musliman sado i vogël që mund të jetë ky rast ata mundohen ta fryjnë, bile edhe ta pëlçasin nga fryrja e tepërt vetëm që të krijojnë një imazh negativ për këtë fe.

“Islami nuk mund të ndalohet nga askush pa marrë parasysh planet dhe strategjitë që përdoren kundër tij. Ai do të arrijë gjithkund ku ka terr apo dritë...”

Ndërsa në anën tjetër, nëse shoh “njerëzit e Zotit” bile edhe duke u grushtuar asgjë nuk ndodh, nuk bëhet e madhe, nëse të tillë njerëz ofendojnë miliona njerëz të tjerë askush nuk flet për ta, nëse udhëheqësit korruptohen dhe zihen me pelë për dore askush nuk e bën të madhe, vidhen gjëra të ndryshme dhe me vlerë nëpër institucionet më të sigurta prapë asgjë. Madje ka raste kur njerëz me pozicione të larta merren me kontrabandë, duke thyer kufijtë përmes përdorimit të autoritetit të tyre, prapë asgjë nuk ndodh. Kjo për momentin është lufta kryesore, ku përqendrohen kafirët dhe që e përdorin kundër muslimanëve, pra, përdorimi i mediave për nënçmimin e tyre. Megjithatë Allahu Fuqiptotë nuk i lë të rrjedhin gjërat, ashtu si i planifikojnë armiqtë e Tij. Ai do t’i bëjë krenarë besimtarët dhe të nënçmuar qafirët, kurse sa i përket Islamit nuk them se e bën krenar pasi ai gjithmonë është i tillë dhe kufirin nuk e nënçmon pasi edhe ai i tillë është dhe ashtu do të mbeten përgjithnjë.

Dobi të hadithit:

1- Islamin si fe të tyre do ta pranojë e tërë bota, pa marrë parasysh ku jetojnë këta njerëz, larg apo afër vendit të fillimit të përhapjes së kësaj feje.

2- Islami nuk mund të ndalohet nga askush pa marrë parasysh planet dhe strategjitë që përdoren kundër tij. Ai do të arrijë gjithkund ku ka terr apo dritë. Përderisa nuk mund të ndalet njëra apo tjetra, atëherë nuk ndalet as feja.

3- Atë do ta pranojë çdo shtëpi, e pasur apo e varfër, pa marrë parasysh kush jeton në të njeri me pozitë apo jo.

4- Islami nuk hyn nëpër shtëpitë e njerëzve vetëm përmes mjeteve të informimit apo të ngjashme me to, duke mbetur kështu vetëm si informacion nëpër këto shtëpi e asgjë tjetër, por me të është si qëllim pranimit i fesë nga njerëzit e këtyre shtëpive.

5- Përhapja e Islamit do të bëhet në formën e saktë të tij, pa devijime, pa shtesa e pa mangësi.

6- Allahu do t’i bëjë krenarë besimtarët dhe do t’i nënçmojë qafirët pa marrë parasysh planet që bëjnë qafirët.

7- Feja përhapet përmes dy lloje njerëzish: muslimanëve dhe vetë qafirëve, edhe pse kjo do të ndodhë përkundër dëshirës së këtyre të fundit.

8- Për të arritur deri tek kjo përhapje masive e fesë, apo e thënë ndryshe deri te kjo fitore patjetër duhet të ndërmerren sebetet, duhet të përpiqen muslimanët dhe të sakrifikojnë sipas nevojave dhe mundësive të tyre të kërkuara nga situatat e ndryshme.

9- Hadithi i lartpërmendur, edhe pse është myzhde për besimtarët prapë se prapë kjo nuk do të thotë që ne duhet të rrimë duarkryq e të presim që ndihma të vijë prej qiellit, ngaqë ajo edhe pse me të vërtetë vjen prej qiellit nga Zoti Fuqiptotë, por prej nesh kërkohet që t’i përvjelim mangët dhe të punojmë maksimalisht për fenë tonë të dashur, ngaqë secili do të shpërblehet për mundin e tij. ■



ABDESI DHE ENERGJIA E NJERIUT

Abdesi është dritë në dynja dhe në ahiret. Në këtë botë lë gjurmë në formë drite në fytyrë dhe qetësi në zemër, dhe e bën jetën e njeriut oazë të blerueshëm dhe burim besimi të fuqishëm, ndërsa në botën tjetër kjo dritë do t'ia zbukurojë fytyrën dhe këmbët e besimtarit.

PRIM. DR. MED. SC. ALI ILJAZI

Allahu i Madhërishtëm na ka shpallur se çdo gjë e ka krijuar nga uji: *“... ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi...”* (Enbija, 30).

Ujin e përziu me dheun dhe krijoi baltën: *“Ai është që ju krijoi nga balta...”* (Enamë, 2).

Dhe nga balta krijoi njeriun: *“Dhe (përkujto) kur Zoti yt engjëjve u tha: “Unë po krijoj njeriun nga balta e tharë, e zezë e me erë.”* (Hixhr, 28).

Pastaj Allahu e frymëzoi me shpirtin e Tij: *“E kur ta përsos atë (në formën e njeriut) dhe t'i jap atij shpirtin që është krijesë Imja...”* (Hixhr, 29).

Askush prej nesh nuk e ka përjetuar krijimin, por do të përjetojmë vdekjen: *“... Ashtu sikundër e kemi filluar krijimin (tuaj), e rikthejmë...”* (Enbija, 104).

Pra, njeriu u krijua nga uji dhe toka, dhe urtësia qëndron në atë që njeriu i kthehet burimit të tij. Kusht për robin është të jetë i pastër kur qëndron para Krijuesit, të marrë abdes, e nëse nuk mundet ai mund të marrë tejemum (pastrim simbolik). Allahu i Madhërishtëm thotë:

“O ju që besuat! Kur doni të ngriheni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla; fërkoni kokat tuaja, e këmbët lani deri në dy zogjtë...” (Maide, 6).

“Askush prej nesh nuk e ka përjetuar krijimin, por do të përjetojmë vdekjen: “... Ashtu sikundër e kemi filluar krijimin (tuaj), e rikthejmë ...”

“Me të vërtetë vepra e mirë jep shkëlqim në fytyrë dhe zemër, rrit nafakën, fuqizon trupin dhe ndikon që të tjerët ta duan...”

Në gjuhën arabe fjala vudu' (abdes) d.m.th. pastërti, qartësi dhe shkëlqesi.

Abdesi është çelësi i xhenetit dhe për këtë i Dërguari i Allahut ka thënë: *“Kush prej jush e plotëson abdesin dhe pas përfundimit thotë: “Dëshmoj që nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Allahut”, do t'i hapen tetë dyer të xhenetit për të hyrë tek ajo që dëshiron.”* (Ahmedi, Muslimi, Ebu Davudi, Nesaiu).

Abdesi është dritë në dynja dhe në ahiret. Në këtë botë lë gjurmë në formë drite në fytyrë dhe qetësi në zemër, dhe e bën jetën e njeriut oazë të blerueshëm dhe burim besimi të fuqishëm, ndërsa në botën tjetër kjo dritë do t'ia zbukurojë fytyrën dhe këmbët e besimtarit.

Ai do të jetë shenjë me të cilën Pejgamberi do t'i njohë besimtarët në Ditën e Gjykimit. Disa sahabë e pyetën Pejgamberin lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të: *“Si do ta njohësh, o i Dërguari i Allahut atë që vjen pas teje nga umeti yt?”* Ai u përgjigj: *“A thua njeriu nuk e njeh kalin e tij, i cili ka shenja të bardha në ballë dhe në këmbë kur gjendet në mesin e kuajve të zinj?”* Sahabët u përgjigjën: *“Natyrshëm që mundet.”* Në këtë Pejgamberi tha: *“Kështu edhe me besimtarët, kur do të vijnë te burimi (hauzi) do të kenë fytyra dhe këmbë të shndritshme nga gjurmët e abdesit.”* (Muslimi, Nesaiu, Ibn Maxhxeh).

Allahu i Madhërishëm i ndihmon njerëzit, që nëpërmes abdesit të pastrohen nga mëkatet dhe të ngrihen në një shkallë më të

lartë. Duke falënderuar për abdesin ata do të jenë të përgatitur të presin takimin me Allahun e Madhërishëm, siç ka thënë i Dërguari i Allahut: *“A do t'ju tregoj me çfarë Allahu i fshin mëkatet dhe i ngre?”* Thanë: *“Po i Dërguar i Allahut.”* Ai tha: *“Marrja e abdesit me rregull, hapat e shumtë deri në xhami, pritja e namazit tjetër pas namazit, ky është xhahadi juaj.”* (Muslimi dhe Tirmidhiu).

Pejgamberi sal-lallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Pastërtia është gjysma e besimit!”* (Muslimi).

Ja se si Islami tregon kujdes për marrjen e abdesit me rregull duke arritur me këtë pastrimin e jashtëm dhe të brendshëm të muslimanit. Vërtetimi më i mirë i kësaj që thekson Islami në vazhdimësinë e pastërtisë trupore e shpirtërore është thënia e Pejgamberit sal-lallahu alejhi ue selem: *“Kush merr abdes me rregull, kryen namazin e detyruar, atij do t'i falen mëkatet.”* (Ahmedi dhe Muslimi).

Atëherë shtrohet pyetja: Ku qëndron fshehtësia e harmonisë në mes njeriut dhe botës?

Kjo është energjia shpirtërore e fesë, e energjisë së balancuar në formën më subtile. Frutat e kësaj energjie paraqiten qartë në trupin dhe në shpirtin e njeriut, sikurse na thotë Ibën Abasi *radijallahu anhu*: *“Me të vërtetë vepra e mirë jep shkëlqim në fytyrë dhe zemër, rrit nafakën, fuqizon trupin dhe ndikon që të tjerët ta duan. Ndërsa vepra e keqe me të vërtetë shkakton nxirje dhe errësirë në fytyrë e zemër, e dobëson trupin, e zvogëlon nafakën dhe shkakton urrejtjen e njerëzve.”*

Abdesi me të vërtetë i kthen fuqinë trupit të njeriut, i pastron mëkatet, sepse mëkatet dhe veprat e këqija ndikojnë në gjendjen psikofizike të njeriut, dhe kështu njeriu e humb fuqinë. Ilaç për këtë është abdesi. Muslimi na tregon në hadithin sahih, që përcillet nga Amër ibën Abese, i cili iu lut

“Sikur njeriu të pastrohej me të gjitha mjetet për pastrim, por nuk do t'i kryente lëvizjet e parapara në rregullat e abdesit me të cilat Krijuesi i Urtë na ka urdhëruar, nuk do ta arrinim energjinë dhe harmoninë e merituar...”

Pejgamberit sal-lallahu alejhi ue selem, duke i thënë:

“O i Dërguari i Allahut më trego për abdesin?” Ndërsa Pejgamberi sal-lallahu alejhi ue selem, i tha: *“Kushdo prej jush, që merr abdes e me këtë rast pastron gojën dhe hundën, nëpër mjekër së bashku me ujin i bien mëkatet nga fytyra, kur pastron duart deri mbi bërryla, nëpër gishtërinj i bien mëkatet nga duart, kur i jep mes’h kokës, së bashku me ujin i bien mëkatet nga koka, kur pastron këmbët deri mbi nyje, me ujin nëpër gishtërinjtë e këmbës i bien mëkatet e këmbës, kur ngrihet dhe falet, dhe e falënderon Allahun e Madhërishëm ashtu siç e meriton Ai, dhe ia dorëzon zemrën Allahut, pas kësaj do të çlirohet nga mëkatet si në ditën kur e ka lindur nëna e vet.”* (Muslimi).

Sikur njeriu të pastrohej me të gjitha mjetet për pastrim, por nuk do t'i kryente lëvizjet e parapara në rregullat e abdesit me të cilat Krijuesi i Urtë na ka urdhëruar, nuk do ta arrinim energjinë dhe harmoninë e merituar.

Shtrohet pyetja: A thua mëkatet lidhen me dorën, këmbën, fytyrën dhe veshin? Është fakt që mëkatet lënë gjurmë të mëdha në meridianet nëpër të cilët rrjedh energjia vitale, si dhe në fushën vitale, e cila rrethon trupin e njeriut. Në realitet mëkatet e çrregullojnë fushën elektromagnetike, e cila

pastaj reflektohet në shëndetin e njeriut.

Njeriu siç dihet paraqet një energji kimike dhe elektromagnetike. Kjo energji kuptohet si energji vitale e cila shndrit nga trupi ynë dhe quhet prana ose vital force. Sido që ta quajmë kjo energji paraqet diçka që realisht është e pranishme (Brecher, Secrets of Energy Work, Darling, Kindrsley).

Abdesi është begati dhe dritë. Allahu i Madhërishëm i lavdëron ata që pastrohen: *“... Allahu i do ata që pendohen dhe ata që pastrohen.”* (Bekare, 222).

Fryti i kësaj dashurie rrjedh nga fshehtësia e emrit të Allahut Hafidh (Ai që vigjilon gjithnjë mbi ne). Në të vërtetë Allahu e ruan njeriun me armë të jashtme dhe të brendshme, e kjo armë është abdesi. A thua edhe kjo nuk është një begati e Allahut të Madhërishëm: *“... në qoftë se përpiqeni t'i numëroni të mirat e All-llahut, nuk do të mund të arrini t'i përkufizoni (në numër)...”* (Ibrahim, 34).

Një abdes mbi tjetrin është sikurse një dritë mbi tjetrën. Për këtë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ue selem, kur nisej për namaz lexonte këtë lutje: *“O Zoti im, më jep dritë në zemër, dritë në sy, dritë në vesh, dritë nga ana e djathtë, dritë nga ana e majtë, dritë mbi mua dhe dritë nën mua.”* (Buhariu).

Në bazë të kësaj që përmendëm është e qartë që njëra prej begative të fshehta për besimtarin është abdesi, i cili rikthen baraspeshën primare në fushën vitale, e cila e rrethon njeriun dhe rregullon çdo çrregullim në meridianet nëpër të cilët rrjedh energjia. Përveç pastërtisë fizike abdesi e mbron njeriun nga të gjithë ndikimet negative të teknologjisë bashkëkohore dhe ndotjes së mjedisit, të cilat ndikojnë në energjinë vitale të njeriut.

O Allah i Madhërishëm, na e mundëso që t'i kryejmë detyrimet e Tua, në mënyrë që Ti të jesh i kënaqur! ■

MESHKUJT DHE FEMRAT

këshilla ime kryesore për bijat e mia është të orvaten që të studiojnë shkencat prej të cilave përfitojnë në aspektin kulturor, edukativ dhe material, edhe në qoftë se rrethanat, siç janë detyrimet familjare nuk ua lejojnë punësimin. Unë ju them që të keni kujdes nga ato objektiva që ndikojnë në vonimin e martesës

ABDULKERIM BEKKAR

Ajo që ju shqetëson më shumë, juve të rinjve dhe të rejave është sigurisht instinkti seksual, të cilin Allahu e ka vendosur në trupin e njeriut me qëllimin e riprodhimit të llojit njerëzor. Unë nuk dëshiroj ta trajtoj këtë dukuri në mënyrë të zgjeruar, mirëpo dëshiroj të paralajmëroj fuqishëm gabimet gjatë bashkëveprimit me këtë forcë të fshehur, që i ngjan më shumë benzinës. Ajo mbetet forcë e dobishme, nëse e përdorim në mënyrën e duhur, mirëpo nëse e vendosim afër zjarrit, atëherë shndërrohet në një fuqi shkatërruese, që e djeg tërësisht të gjallin. Një dijetar e ka krahasuar energjinë seksuale me një shkëmb të madh rrëzë një mali të lartë, që është duke qëndruar me shekuj në këtë pozicion. Nëse vjen dikush dhe e lëviz shkëmbi fillon të rrotullohet e rrotullohet me shpejtësi dhe nuk ka mundësi më asnjë



forcë njerëzore që ta ndalojë. Ajo që e lëviz epshin te djemtë dhe vajzat është e kufizuar nga një sërë shkaqesh, ku ndër më kryesoret janë:

- të menduarit për çështjet seksuale dhe përdorimi i fantazive lidhur me to. Për këtë shkak boshllëku dhe preokupimi me vetveten është njëra prej arsyeve shumë të forta, që e aktivizon instinktin seksual;
- shikimi i skenave të turpshme, ku meshkujt shikojnë femrat lakuriq dhe anasjelltas; këtu hyn edhe përzierja dhe qëndrimi në një vend i të dy gjinive;
- frekuentimi i takimeve dhe vendeve që të nxisin seksualisht;
- shoqërimi me njerëz të pamoralshëm dhe të shturur, që nuk kanë asnjë ambicie dhe aspiratë ndaj ndonjë çështjeje të rëndësishme dhe madhore.

Çfarë mund të përfitojnë të rinjtë dhe të rejat nga kjo që thamë më lart?

1. Kushdo prej jush le të preokupohet me gjëra të dobishme dhe me vlerë, duke i

harxhuar energjitë e tij për to. Marrja me ushtrime sportive ndikon pozitivisht në zvogëlimin e këtij instinkti dhe është shumë e dobishme për dobësimin e presionit të epshit seksual.

2. Martesa e hershme është mburojë (virtyt, mirësi) e madhe për atë që ka mundësi ta bëjë dhe me lejen e Allahut kjo përbën një kala të fortifikuar. Prandaj të rinjtë dhe të rejat duhet të planifikojnë seriozisht lidhur me këtë dhe njëkohësisht shoqëria duhet t'i lehtësojë rrethanat, që t'ua bëjë të rinjve sa më të lehtë një gjë të tillë.

3. Forcimi i aspektit shpirtëror për këdo nga ju konsiderohet si diçka esenciale lidhur me këtë problematikë. I Dërguari i Allahut i këshilloi të rinjtë që të agjërojnë. Përballja kryesore me rrjedhën e vrullshme të epshit duhet të bëhet me fuqizimin e forcës shpirtërore, duke e bërë atë sa më të fortë, gjithëpërfshirëse dhe të përqendruar në praktikimin e urdhrave të fesë.

4. Shoqërimi me njerëz të devotshëm, të mirë, me zemra të pastra dhe aspirata të larta.

5. Braktisja e takimeve dhe e vendeve në të cilat flitet për seksin.

6. Ulja e shikimit dhe mospërzjerja me gjininë e kundërt, sipas mundësisë dhe rrethanave.

7. Çdokush prej jush le të mendojë 100 herë para se të bëjë hapin e gabuar, i cili në jetën e tij lë mbresën më të shëndtuar, ndërsa në veten e tij lë kujtimin më të keq.

Në vazhdim nuk synoj të flas këtu për gjërat që i bëjnë meshkujt dhe femrat qenie të ndryshme, mirëpo ideja ime është të nxjerr në pah diçka më të rëndësishme, atë se dallimi i tyre në natyrshmëri dhe anatomi për pasojë mbart edhe dallime në detyra dhe përgjegjësi. Përbërja e anatomisë trupore, psikike dhe sentimentale e femrave dallon plotësisht nga e meshkujve. Për këtë

“...Martesa e hershme është mburojë (virtyt, mirësi) e madhe për atë që ka mundësi ta bëjë dhe me lejen e Allahut kjo përbën një kala të fortifikuar...”

arsye, femra është zgjedhur të luajë një rol të kundërt nga partneri i saj –mashkulli-.

Femra ngel shtatzënë dhe më pas lind. Ajo konsiderohet përgjegjësjë kryesore e rritjes së brezave. Ajo që ngjall interesimin dhe tërheq vëmendjen e saj nuk është pikërisht ajo që mbizotëron ndjeshmërinë e burrave.

Në mësimet tona fetare dhe në doket e zakonet që njerëzit i kanë pranuar si të drejta, ajo që kërkohet nga femra është në kontradiktë me atë që lipset prej mashkullit në aspektin shoqëror, në rrafshin e punës dhe të profesionit. Me fjalë të tjera, aspiratat e femrës për të ardhmen duhet të jenë ato të gruas dhe jo ato të burrit. Kjo nënkupton që synimi **parësor** i femrës duhet të jetë angazhimi në ndërtimin e familjes fetare, të lumtur dhe të bashkuar. Ajo duhet ta përgatisë veten në aspektin edukativ dhe kulturor për këtë objektiv të ndershëm dhe kjo është parësore për të. **Së dyti**, studimi i saj në universitet të jetë në përputhje me atë që përmendëm deri tani, d.m.th. që lënda për të cilën përgatitet duhet të jetë diçka prej së cilës do të përfitojnë gjinia femërore, për shembull edukimi apo mjekimi, dhe që puna pas diplomimit të jetë e përshtatshme me pozicionin e saj si zonjë shtëpie. Nisur nga ky fakt deklarojmë, se nuk është e udhës që femra të zgjedhë për të studiuar teknologjinë e prodhimit, mekanikën apo energjetikën, njëlloj siç nuk

është e përshtatshme të studiojë veterinarinë apo bujqësinë. Në përgjithësi, këshilla ime kryesore për bijat e mia është të orvaten që të studiojnë shkencat prej të cilave përfitojnë në aspektin kulturor, edukativ dhe material, edhe në qoftë se rrethanat, siç janë detyrimet familjare nuk ua lejojnë punësimin. Unë ju them që të keni kujdes nga ato objektiva që ndikojnë në vonimin e martesës, me qëllim që të mos pendoheni atëherë kur nuk bën dobi pendimi.

Mos tento të futesh në garë me meshkujt, ngaqë ti je krijuar për të luajtur një rol tjetër nga ç'janë krijuar ata. Ti duhet të marrësh mësim nga pozita tragjike në të cilën gjendet femra në shumicën e vendeve të Lindjes dhe të Perëndimit.

Mundësitë në jetë janë të shumta, prandaj prej teje kërkohet që interesimi për martesë, për krijimin e familjes muslimane dhe edukimin e mirëfilltë të fëmijëve të jetë preokupimi yt kryesor.

Feminiteti është arma më e sofistikuar me të cilën femra duhet të luftojë, prandaj mos hiq dorë nga kjo armë me qëndrime dhe veprime jo të duhura për ty.

Pozita në shoqëri nuk qëndron te madhështia e specializimit dhe e profesionit, por tek ajo se sa janë ato (specializimi dhe profesioni) të përshtatshme për ty dhe sa i zotëron me sukses. ■

Nga arabishtja: Agron Terziqi


VËNIA E BASTIT PËR GARA?

Pyetje: A lejohet vënia e bastit për gara me kuaj dhe tjera?

Përgjigje: I falënderuar qoftë Allahu. Garat me kuaj janë të lejuara. I Dërguari i Allahut, *sal-lAllahu alejhi ue selem*, thotë: “Çmimi për fituesin lejohet në këto tre gara: në gjueti, garat e deveve dhe kuajve”. (Tirmidhiu, Nesaiu, Ebu Davudi dhe si të saktë e ka vlerësuar Albani në librin Sahih Ebu Davud). Fjala “sebk” e përmendur në hadith ka kuptimin e kompensimit, shpërblimit për fituesin. Nga hadithi në fjalë kuptojmë, se shpenzimi i të hollave për gara të kuajve është i lejuar, pa marrë parasysh kush i jep ato të holla, një garues, të gjithë garuesit apo ndonjë palë e tretë si për shembull shteti.

Në këtë lejim nuk bën pjesë vënia e basteve, se kush do të fitojë nga garuesit. Ky veprim bën pjesë në bixhozin e ndaluar dhe nuk ka lidhje me çmimin e caktuar për fituesin në këto tre raste. Kjo formë e bixhozit është e përhapur në shumë vende dhe ka shkaktuar humbje pasurie dhe probleme familjare e shoqërore.

Meqë formimi i fondit të basteve është i ndaluar, edhe angazhimi në bastore është i ndaluar, ngaqë



është bashkëpunim dhe ndihmë për një gjë të ndaluar-kumarin, të cilin Allahu e ka përmendur krahas alkoolit: **“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyra nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni!”** (Maide, 90). Dijetari Abdul Mexhid Selim thotë: “...nga kjo kuptojmë se vënia e basteve për gara me kuaj apo të ngjashme bën pjesë në bixhozin e ndaluar fetarisht për të cilin nuk ka prova lejimi. Përkundrazi provat fetare e ndalojnë një veprim të tillë dhe gjithë llojet e basteve. Çdo ditë jemi dëshmitarë për pasojat e dëmshme të veprimeve në fjalë, duke u shpenzuar pasuri të tëra, u shembën shtëpi të familjeve të ndershme, të sprovuarit me

këtë fatkeqësi kryejnë vjedhje dhe krime të shumta. Një numër i konsiderueshëm prej tyre bën edhe vetëvrasje. Tek njeriu që i sheh këto pasoja shkatërruese të basteve dhe kumarit shtohet bindja se ndalimi i këtij veprimi nxjerr në pah mëshirën e Allahut dhe urtësinë e Tij absolute gjatë ligjësimit të dispozitave.

(FETAVA EZ'HER).

Pyetje: Disa njerëz blejnë suplementin sportiv të gazetës “Al Sharq Al Awsat” për të mbushur kuponat, duke zgjedhur opsionin për të cilin mendojnë se do të fitojë në gara. Më mbushjen e këtyre kuponave ata synojnë të fitojnë shpërblime dhe në të njëjtën kohë shpenzojnë të holla. Prej dijetarëve të nderuar kërkoj përgjigje për

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

këtë çështje duke synuar që këtyre njerëzve në fjalë t'u bëhet e qartë dispozita fetare rreth kësaj çështjeje.

Përgjigjja: Kjo veper nuk është e lejuar, sepse bëhet fjalë për vënie basti, që bën pjesë në bixhozin e ndaluar. Allahu, subhanehu ve teala thotë: **“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyra nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni!”**

Kjo veper është e ndaluar dhe përfitimi material prej saj është i ndaluar. Allahu është dhurues i suksesit. Të nënshkruar në këtë fetva janë dijetarët e nderuar: Abdulaziz ibën Baz, Abdulaziz Al Shejhi, Abdullah Gudejan, Salih Feuzani, Bekr Ebu Zejdi.

FETVATË E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM (15/244)

Pyetje: A lejohet pjesëmarrja në një turne futbollit në të cilin tubohen prej lojtarëve të holla dhe pastaj luhen tre xhiro dhe fituesit i jepet dhurata në fund; a është kjo prej kumarit të ndaluar?

Përgjigje: Garat sportive dhe të tjera, në të cilat pjesëmarrësit paguajnë të holla, apo për fituesit caktohen çmime, janë gara të ndaluara dhe besimtarit nuk i lejohet pjesëmarrja në to, as aprovimi i tyre, as ndihmesa e tyre në ndonjë formë. Nga këto gara përjashtohen ato që kanë kuptimin e përgatitjes për xhihad dhe garat e ditorisë, që nxisin në përfitimin e njohurive të dobishme dhe në zhdukjen e injorancës. Forma e përmendur në pyetje është e ndaluar dhe është bixhoz dhe bast i ndaluar.

I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: **“Çmimi për fituesin lejohet në këto tre gara: në gjueti, garat e deveve dhe kuajve.”** (Tirmidhiu, Nesaiu, Ebu Davudi dhe si të saktë e ka vlerësuar Albani në librin Sahih Ebu Davud).

Këto tre kategori garash kanë të bëjnë

me artet e luftës, që janë baza e xhihadit. Disa dijetarë i kanë bashkangjitur edhe garat e Kuranit, hadithit dhe fikhut, në të cilat lejohet caktimi i shpërblimit.

Është parashtruar kjo **pyetje:** Në këto ditë jemi dëshmitarë të përgatitjeve për turne dhe kupa sportive, që i organizojnë disa klube. Në këto turne krejt ekipet paguajnë një shumë të hollash, ndërsa ekipi organizator blen kupën dhe dhuratat. Ekipi fitues e merr kupën ndërsa vendi i dytë dhe i tretë dhuratat tyre. Kërkojmë përgjigje Allahu ju shpërbleftë?

Përgjigjja: Nëse shpërblim e paguan dikush i tretë, që nuk është garues kjo nuk bën pjesë në bixhozin e ndaluar. Nëse shpërblimi është prej të hollave që i paguan garuesi, atëherë kemi të bëjmë me bixhoz të ndaluar për të cilin Allahu, subhanehu ve teala, thotë: **“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni!”** (Maide, 90).

Nëse ekipet që garojnë janë tre dhe dy ekipe e paguajnë shumën e pjesëmarrjes ndërsa ekipi i tretë nuk paguan dhe shpërblimin e merr fituesi edhe kjo formë nuk është e lejuar. I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: **Çmimi për fituesin lejohet në këto tre gara: në gjueti, garat e deveve dhe kuajve.** I Dërguari i Allahut këtë formë e ka përkufizuar vetëm me këto tre lloje garash, sepse ato kanë të bëjnë me xhihadin. Allahu është Dhuruesi i suksesit.

(FETAVA ISLAMIJE, 4/433) ■

Nga arabishtja: Talha KURISHI